



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 43

Tiranë – E mërkurë, 25 shkurt 2026

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 23/2026, datë 3.2.2026	Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike.....	3323
Dekret i Presidentit nr. 87, datë 19.2.2026	Për shpallje ligji.....	3344
Dekret i Presidentit nr. 88, datë 20.2.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	3344
Dekret i Presidentit nr. 89, datë 20.2.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	3344
Dekret i Presidentit nr. 90, datë 20.2.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	3345
Dekret i Presidentit nr. 91, datë 20.2.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	3345
Dekret i Presidentit nr. 92, datë 20.2.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	3345
Dekret i Presidentit nr. 93, datë 20.2.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	3346
Dekret i Presidentit nr. 94, datë 20.2.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	3346
Dekret i Presidentit nr. 95, datë 20.2.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	3346
Udhëzim i ministrit të Arsimit nr. 3, datë 18.2.2026	Për organizimin dhe zhvillimin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve në arsimin fillor, viti shkollor 2025–2026.....	3346

Urdhër i ministrit të Financave nr. 47, datë 19.2.2026	Për delegimin e kompetencave.....	3347
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 157, datë 17.2.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Holandës.....	3348
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 158, datë 17.2.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetet e Bashkuara të Amerikës.....	3349
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 159, datë 17.2.2026	Për shfuqizimin e urdhrit nr. 49, datë 14.1.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Spanjës”.....	3350
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 41, datë 11.2.2026	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin janar 2026, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.....	3350
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 42, datë 11.2.2026	Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “INFO-Telecom” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	3352
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 43, datë 11.2.2026	Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Nova Solar System” sh.p.k. si mjet për garantimin e detyrimit ndaj Raiffeisen Bank sh.a.....	3353
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 44, datë 11.2.2026	Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Parisol” sh.p.k.....	3355
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Azbi Merkohasanaj.....	3357



LIGJ
Nr. 23/2026

PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT
TË INTERESIT NË USHTRIMIN E
FUNKSIONEVE PUBLIKE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është forcimi i integritetit të zyrtarëve dhe të institucioneve publike, si dhe garantimi i kryerjes së funksioneve publike nga ana e zyrtarëve publikë në mënyrë objektive, të paanshme dhe transparente në interesin më të mirë të mundshëm të publikut dhe të besimit të tij ndaj institucioneve publike nëpërmjet identifikimit, parandalimit, menaxhimit dhe zgjidhjes së konfliktit të interesit publik dhe privat të zyrtarëve.

Neni 2
Objekti

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i parimeve, rregullave dhe procedurave për veprimet dhe veprimtaritë e zyrtarëve gjatë kryerjes së funksioneve publike, të personave që mbajnë pozicione drejtuese në ndërmarrje shtetërore, në nivel kombëtar ose vendor, masat për parandalimin, identifikimin, menaxhimin dhe zgjidhjen e rasteve të konfliktit të interesit publik dhe privat të zyrtarëve gjatë dhe pas ushtrimit të funksionit publik, si dhe masat për shkeljen e dispozitave të përcaktuara në këtë ligj.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Institucion publik” për qëllim të këtij ligji do të kuptohet çdo institucion shtetëror, qendror ose vendor, çdo njësi apo subjekt i krijuar ose në varësi të tyre, përfshirë edhe ndërmarrjet shtetërore në nivel qendror dhe vendor, shoqëritë tregtare me pjesëmarrje të kapitalit shtetëror ose vendor, organizatat jofitimprurëse dhe personat e tjerë juridikë, të zotëruar nga institucionet qendrore ose vendore apo organet dhe subjektet e krijuara dhe/ose në varësi të çdo organi të enteve publike, çdo organi të pushtetit vendor, çdo organi të Forcave të Armatosura, në masën që ato kryejnë funksione administrative, si dhe çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo formë tjetër të parashikuar në legjislacionin në fuqi e drejta për ushtrimin e funksioneve administrative publike.

2. “Konflikt i interesit” është gjendja e konfliktit ndërmjet funksionit publik dhe interesave private të një zyrtari për të cilën ligji ka vendosur kufizime, ndalime ose në të cilën zyrtari ka interesa private të drejtpërdrejta ose të tërthorta, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisë të tij publike.

3. “Zyrtar publik” është çdo zyrtar deklarues dhe jodeklarues, që kryen detyra dhe ushtron funksione publike të përcaktuara shprehimisht në fushën e veprimit të këtij ligji dhe ligjeve të tjera organike, të cilat rregullojnë veprimtarinë në institucionet publike.

4. “Zyrtar publik deklarues” është zyrtari i përcaktuar në legjislacionin përkatës për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë.

5. “Zyrtar publik jodeklarues” është çdo zyrtar tjetër i punësuar, i zgjedhur ose i emëruar në mënyrë të përhershme apo të përkohshme në një institucion publik, i ngarkuar për të ushtruar funksione apo detyra publike, i cili nuk përfshihet në kategorinë e subjekteve që mbartin detyrim për deklarim të interesave private pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

6. “Persona të lidhur me zyrtarin publik” janë bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë, të cilët për shkak të kësaj marrëdhënie mbartin detyrime ligjore sipas përcaktimeve të bëra në ligj.

7. “Persona të tjerë të lidhur me zyrtarin publik” janë rrethi i personave të afërt deri në shkallë të dytë,



personi i besuar, drejtuesi dhe ortakët e shoqërisë ku zyrtari apo personat e lidhur zotërojnë aksione në mënyrë aktive apo të tërthortë, si dhe çdo person fizik apo juridik, i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët interesi privat.

8. “Person i besuar” është personi fizik ose juridik, që ushtron në mënyrë të pavarur të drejtat e administrimit të shoqërisë tregtare apo të drejta të tjera të përcaktuara me marrëveshje “Trust” të lidhur me zyrtarin për aksionet ose pjesët në kapital të zotëruara në mënyrë aktive ose të tërthortë nga zyrtari, duke mundësuar zotërimin e tyre në mënyrë pasive. Personi i besuar nuk mund të jetë nga rrethi i personave të lidhur apo personave të tjerë të lidhur me zyrtarin ose një zyrtar, apo person tjetër me lidhje varësie, qoftë edhe të tërthortë, për shkak të funksionit publik me zyrtarin, si dhe një organizatë jofitimprurëse ose një shoqëri ku zyrtari zotëron pjesë në kapital, ose aksione apo ka pasur ose ka marrëdhënie interesi të çfarëdo lloji.

9. “Marrëveshje “Trust”” ka të njëjtin kuptim sipas legjislacionit në fuqi për regjistrin e pronarëve përfitues.

10. “Personi përgjegjës i shoqërisë” është subjekti që në bazë të legjislacionit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare drejton shoqërinë në të cilën zyrtari dhe personat e lidhur me të zotërojnë në mënyrë aktive ose të tërthortë aksione apo pjesë në kapital.

11. “Zotërimi aktiv i aksioneve ose pjesëve në kapital” është ushtrimi i plotë i të gjitha të drejtave që burojnë nga pronësia mbi aksionet ose pjesët në kapital të shoqërisë tregtare.

12. “Zotërim i tërthortë i aksioneve ose pjesëve në kapital” është zotërimi i aksioneve ose i pjesëve në kapital nga zyrtari publik nëpërmjet një shoqërie tregtare të çfarëdo forme të parashikuar në ligj, e cila zotëron aksione ose pjesë në kapital të një shoqërie tjetër tregtare.

13. “Zotërimi pasiv i aksioneve ose pjesëve në kapital” është gjendja në të cilën pronari ruan të drejtën e përfitimit të fryteve të pronësisë, por nuk mund të ushtrojë vetë të drejtat që burojnë nga pronësia mbi aksionet ose pjesët në kapital të shoqërisë tregtare. Të gjitha veprimet e tjera si administrimi apo drejtimi i shoqërisë kryhen nga personi i besuar nga zyrtari, në emër të vet, por për llogari të zyrtarit mbi bazën e një marrëveshje “Trust” lidhur ndërmjet tyre.

14. “Dhuratë” është çdo përfitim, send, shërbim, e drejtë ose favor, me vlerë materiale ose jomateriale, fituar pa kundërshtpërblim ose me kushte preferenciale, që i ofrohet zyrtarit publik apo personave të lidhur me të, ose tërthorazi me ushtrimin e detyrave të tij zyrtare. Dhurata përfshin, por nuk kufizohet vetëm në: mikpritje, pagesa, udhëtime, akomodim, përdorim prone, falje borxhi, kredi me kushte të favorshme, si dhe çdo përfitim tjetër që nuk përbën një zakon të justifikueshëm shoqëror ose kulturor.

15. “Vendimarrje” është procesi gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit dhe/ose kontratës administrative, si dhe fazat paraprake të këtij procesi, ku pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit kanë rëndësi thelbësore dhe sjellin pasoja në përcaktimin e përmbajtjes përfundimtare të aktit.

16. “ILDKPKI” është Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave.

17. “Regjistri i zyrtarëve publikë” është një regjistër i veçantë, ku evidentohen zyrtarët publikë, me qëllim verifikimin, kontrollin dhe hetimin administrativ, për efekt të parandalimit të konfliktit të interesave, që administrohet, përditësohet dhe mirëmbahet nga ILDKPKI-ja dhe njësitë përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave në institucionet publike sipas fushës së përgjegjësisë.

18. “Tregtari” ka të njëjtin kuptim sipas legjislacionit në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

19. “Epror i një zyrtari” është një zyrtar tjetër, një njësi organizative brenda institucionit publik, drejtuesi më i lartë i institucionit publik, që ka kompetenca emëruese, drejtuese, urdhëruese, vlerësuese ose kontrolluese, të drejtpërdrejta mbi zyrtarin sipas legjislacionit në fuqi.

20. “Institucion epror” është institucioni publik ose organ i tij që, sipas ligjeve në fuqi, ka kompetenca rregulluese, emëruese, drejtuese, urdhëruese, vlerësuese ose kontrolluese mbi një institucion tjetër publik, ose organ të tij, ku zyrtari kryen funksionet, detyrat dhe ushtron kompetencat e tij.

21. “Shoqëritë” përfshin të gjitha format e organizimit në shoqëri tregtare, si dhe format e thjeshta të organizimit sipas Kodit Civil.



22. “Organizatë jofitimprurëse” ka të njëjtin kuptim si në legjislacionin në fuqi për organizatat jofitimprurëse.

23. “Marrëdhënie personale” është çdo marrëdhënie familjare, shoqërore apo organizim shoqëror afatgjatë, e miqësisë apo armiqësisë së njohur, pavarësisht nëse është ose jo e formalizuar ligjërisht, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në ushtrimin e detyrave publike nga zyrtari.

24. “Marrëdhënie profesionale ose pune” është çdo bashkëveprim formal ose joformal midis personave ose subjekteve të krijuara me qëllim kryerjen e aktiviteteve profesionale, ofrimin e shërbimeve, shërbimeve organizative ose ndjekjen e objektivave tregtarë dhe financiarë, që ka ekzistuar brenda 2 (dy) vjetëve të fundit. Një marrëdhënie e tillë përfshin, por nuk kufizohet vetëm në: marrëdhënie punësimi, këshillimi, marrëveshje kontraktore, anëtarësi në borde, partneritete ose sipërmarrje të përbashkëta, dhe është e rëndësishme kur mund të shkaktojë një konflikt interesi faktik, të mundshëm ose në dukje.

25. “Akt administrativ” ka të njëjtin kuptim sipas Kodit të Procedurave Administrative.

26. “Kontratë administrative” ka të njëjtin kuptim sipas Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 4

Fusha e zbatimit

Dispozitat e këtij ligji përcaktojnë rregulla të zbatueshme për:

a) çdo zyrtar publik që ushtron detyra, funksione e kompetenca të caktuara në një institucion publik sipas kuptimit të këtij ligji;

b) çdo zyrtar publik që merr pjesë në vendimmarrje për akte administrative, kontrata administrative, akte të organeve gjyqësore, të prokurorisë, akte noteriale, ekzekutimin e titujve ekzekutivë dhe akte normative;

c) çdo institucion publik dhe çdo shoqëri tregtare në pronësi shtetërore sipas përcaktimit në këtë ligj;

ç) personat e lidhur me zyrtarin publik dhe personat e tjerë të lidhur me zyrtarin publik në mënyrën dhe masën e përcaktuar në këtë ligj;

d) personat që mbajnë pozicione drejtuese në ndërmarrje shtetërore në nivel kombëtar ose vendor.

Neni 5

Format e konfliktit të interesit

Konflikti i interesit shfaqet në këto forma:

a) konflikt i vazhdueshëm i interesave është gjendja në të cilën konflikti i interesit mund të shfaqet në mënyrë të përsëritur dhe/ose të shpeshtë në të ardhmen;

b) konflikt i interesave rast pas rasti është gjendja në të cilën interesat private të zyrtarit ndikojnë, mund të ndikojnë ose duken sikur ndikojnë në ushtrimin e detyrave publike në raste të veçanta të vendimmarrjes ose veprimeve zyrtare. Ky konflikt mund të marrë një nga format e mëposhtme:

i. “konflikt faktik i interesave” është gjendja në të cilën interesat private të zyrtarit ndikojnë ose kanë ndikuar në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij zyrtare;

ii. “konflikt në dukje i interesave” është gjendja në të cilën interesat private të zyrtarit duken, në pamje ose në formë, sikur kanë ndikuar, ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësi të tij zyrtare, por, në fakt, ndikimi nuk ka ndodhur, nuk ndodh ose nuk ka mundësi të ndodhë;

iii. “konflikt i mundshëm i interesave” është gjendja në të cilën interesat private të zyrtarit mund të shkaktojnë në të ardhmen shfaqjen e konfliktit faktik ose në dukje të interesit nëse zyrtari do të përfshihej në detyra apo përgjegjësi të caktuara.

Neni 6

Interesat private

Interesat private të zyrtarit publik janë ato interesa që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga:

a) të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloji natyre;

b) çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile që krijon një përfitim ose ndikim;

c) dhurata, premtime, favorizime, trajtime preferenciale ose privilegje të tjera;

ç) marrëdhënie të njohura të miqësisë apo armiqësisë;

d) çdo marrëdhënie personale, profesionale/ pune ose tregtare sipas parashikimeve të këtij ligji, që është e njohur dhe e rëndësishme për ushtrimin e funksioneve publike;



dh) angazhimin në veprimtari private me qëllim fitimi ose në çdo veprimtari tjetër që gjeneron të ardhura, përfshirjen në organizata jofitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale, politike ose shtetërore, si dhe çdo formë tjetër e pjesëmarrjes në organizata;

e) çdo interes tjetër privat, përfshirë interesat e personave të lidhur me zyrtarin, që përbën shkak për shfaqjen e një konflikti interesi, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

KREU II PARIMET E KUFIZIMIT TË INTERESAVE PRIVATE DHE PËRGJEGJËSITË LIGJORE TË SUBJEKTEVE TË LIGJIT

Neni 7

Parimi i ligjshmërisë

Parandalimi dhe trajtimi i konfliktit të interesit bazohet në respektimin e ligjit, garantimin që çdo masë apo veprim i ndërmarrë nga zyrtarët ose institucionet publike të mbështetet në dispozita të qarta, të kuptueshme dhe të parashikueshme, duke garantuar sigurinë juridike dhe barazinë para ligjit për të gjithë zyrtarët publikë.

Neni 8

Parimi i integritetit

Zyrtari publik e ushtron funksionin e tij me ndershmëri, paanësi dhe në përputhje me interesin publik, duke shmangur çdo ndikim nga interesat private që cenojnë besimin e publikut dhe integritetin e vendimarrjes.

Neni 9

Parimi i paanësisë dhe objektivitetit

Zyrtari publik e ushtron funksionin e tij në mënyrë të paanshme dhe objektive, duke u bazuar në vlerësimin e fakteve dhe në zbatimin e ligjit, pa u ndikuar nga interesa private, bindje politike apo çdo formë tjetër ndikimi të papërshtatshëm.

Neni 10

Parimi i proporcionalitetit

1. Masat për parandalimin, menaxhimin dhe sanksionimin e rasteve të konfliktit të interesit duhet të jenë në përpjesëtim me rëndësinë e detyrave, përgjegjësi dhe kompetencave të ushtruara nga zyrtari ose institucioni publik përkatës.

2. Gjatë ushtrimit të funksioneve, ILDKPKI-ja dhe njësitë përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesit brenda institucioneve publike kryejnë hetime administrative vetëm në masën e nevojshme, të përshtatshme dhe proporcionale me arritjen e objektivit të parandalimit të konfliktit të interesit.

Neni 11

Parimi i transparencës

Parandalimi dhe trajtimi i konfliktit të interesave bazohet në transparencën e veprimtarisë së zyrtarëve dhe të institucioneve publike përmes dokumentimit të vendimarrjes, qartësisë së procedurave dhe aksesit të publikut në informacion, me qëllim forcimin e besimit në institucionet publike dhe nxitjen e llogaridhënies.

Neni 12

Parimi i barazisë dhe gjithëpërfshirjes

Kufizimet e interesave private, të përcaktuara në këtë ligj dhe në ligjet e tjera, zbatohen në mënyrë të barabartë dhe gjithëpërfshirëse për të gjithë zyrtarët e institucioneve publike, në përputhje me detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e tyre.

Neni 13

Parimi i mirëkuptimit dhe bashkëpunimit

Trajtimi dhe zgjidhja e rasteve të konfliktit të interesave bëhet në bazë të mirëkuptimit dhe bashkëpunimit ndërmjet zyrtarit publik dhe eprorit ose institucionit epror, me qëllim parandalimin dhe zgjidhjen sa më të shpejtë dhe efektive të situatave që lindin nga prania e interesave private.

Neni 14

Parimi i përgjegjësisë personale

Zyrtari publik është përgjegjës për parandalimin dhe zgjidhjen e çdo situatë të konfliktit të interesit që



lidhet me të, si dhe për interesat private të personave të lidhur drejtpërdrejt apo personave të tjerë të lidhur me zyrtarin publik, në përputhje me detyrimet e përcaktuara në këtë ligj.

Neni 15

Parimi i parandalimit mbi ndëshkimin

Parandalimi i konfliktit të interesit përbën qëllimin parësor të këtij ligji dhe realizohet përmes marrjes së masave të qarta dhe të zbatueshme nga zyrtarët dhe institucionet publike përpara zbatimit të masave ndëshkuese të parashikuara në këtë ligj.

KREU III

**DETYRIMET E ZYRTARËVE PËR
PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË
INTERESIT**

Neni 16

**Përgjegjësia për parandalimin e konfliktit të
interesit**

1. Zyrtari publik nga momenti i zgjedhjes ose emërimit të tij dhe gjatë të gjithë periudhës së ushtrimit të funksionit publik ka për detyrë parandalimin dhe zgjidhjen e çdo situatë të konfliktit të tij të interesit në mënyrë të menjëhershme dhe efektive.

2. Kur zyrtari publik ka dyshime për ekzistencën e një konflikti interesi, ai informon pa vonesë eprorin ose institucionin përkatës, me qëllim marrjen e masave të nevojshme për parandalimin ose zgjidhjen e tij.

3. Çdo epror dhe institucion epror marrin të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar dhe zgjidhur rastet e konfliktit të interesit.

Neni 17

**Përgjegjësia e zyrtarit për interesat private
të personave të lidhur**

1. Zyrtari publik nga momenti i zgjedhjes ose emërimit dhe gjatë të gjithë periudhës së mbajtjes së detyrës publike ka detyrimin e parandalimit dhe të zgjidhjes menjëherë, dhe në mënyrë efektive çdo situatë konflikti interesi që lidhet me interesat e tij private, edhe kur ato përfshijnë personat e lidhur me të.

2. Për qëllimet e këtij neni, interesat private të personave të lidhur dhe të personit të besuar trajtohen sikur të ishin të zyrtarit publik, kur natyra e marrëdhënies së tyre rezultojnë në një ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në ushtrimin e detyrave të zyrtarit publik ose duket se krijon një konflikt interesi.

Neni 18

**Përgjegjësia për kufizimin e zotërimit të
tërthortë të interesave**

1. Kufizimet dhe ndalimet e parashikuara në këtë ligj për çështje të veçanta zbatohen edhe kur zotërimi i aksioneve ose i pjesëve në kapital nga zyrtari publik lidhet me një shoqëri tregtare, ortakëri, ose shoqëri të thjeshtë, e cila zotëron aksione ose pjesë në kapital të një shoqërie tjetër tregtare, ortakërie ose shoqërie të thjeshtë, dhe kjo e fundit del si palë përfituese nga vendimarrja e zyrtarit.

2. Kufizimet dhe ndalimet e parashikuara në këtë ligj për raste të veçanta zbatohen edhe kur zyrtari zotëron interesa të lidhur me persona fizikë ose juridikë të regjistruar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të cilët zotërojnë ose kontrollojnë një person juridik të regjistruar në Republikën e Shqipërisë dhe nga të cilët, në mënyrë të tërthortë, krijohen të drejta mbi këtë person. Në këto raste, kufizimi i interesave të zyrtarit dhe/ose të personit juridik të zotëruar ose të kontrolluar prej tij zbatohet në atë masë që veprimi i tërthortë prodhon të njëjtin rezultat.

Neni 19

Barra e provës

Kur të dhënat e mbledhura nga subjektet kontrolluese nëpërmjet procedurave administrative ose burimeve të tjera të ligjshme provojnë ekzistencën e interesave private të zyrtarit publik, që mund të shkaktojnë konflikt interesi për shkak të kufizimeve dhe ndalimeve të përcaktuara në këtë ligj, gjatë procedurës së hetimit të konfliktit të interesave, zyrtari publik ka të drejtën për të paraqitur prova dhe për t'u shprehur në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative.



KREU IV DEKLARIMI I KONFLIKTIT TË INTERESAVE

Neni 20

Deklarimi i interesave private për zyrtarët publikë

1. Zyrtari publik deklarues mbart detyrimin për deklarim të interesave private për vete dhe personat e lidhur me të pranë ILDKPKI-së, në përputhje me afatet dhe procedurat e deklarimit të parashikuara në legjislacionin në fuqi për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë.

2. Zyrtari publik jodeklarues gjatë periudhës së ushtrimit të funksionit publik është i detyruar të plotësojë formularin e deklarimit për evidentimin e interesave private të tij dhe të personave të lidhur me të:

- a) kur fillon marrëdhënien e punës ose emërohet në detyrë;
- b) me lindjen e interesave të reja private, ndryshimin e interesave private ekzistuese dhe/ose shuarjen e tyre;
- c) kur përfundon funksionin apo detyrën.

3. Zyrtari publik jodeklarues mbart detyrimin për deklarim të interesave private për vete dhe për personat e lidhur me të pranë njësisë përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave të institucioneve përkatëse brenda 30 ditëve nga:

- a) data e fillimit të detyrës;
- b) data e krijimit, ndryshimit apo shuarjes së interesave private;
- c) data e përfundimit të funksionit apo detyrës.

Neni 21

Deklarimi rast pas rasti i interesave private

1. Zyrtari gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, kur përfshihet në vendimmarrje që mund të bëhet shkak për lindjen e konfliktit të interesave, në bazë të njohjes së tij dhe në mirëbesim, kryen vetëdeklarim paraprak rast pas rasti të interesave private të tij, duke përfshirë interesat private të personave të lidhur dhe të personave të tjerë të lidhur me të.

2. Deklarimi rast pas rasti i interesave private bëhet nga zyrtari publik sa herë kërkohet nga eprori direkt, titullari i institucionit, institucioni epror ose

ILDKPKI-ja. Deklarimi, si rregull, kërkohet dhe kryhet paraprakisht. Nëse kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi kërkohet të bëhet sa më shpejt, por jo më vonë se 7 ditë kalendarike nga data e kërkesës ose e konstatimit të konfliktit të interesit nga zyrtari publik.

3. Vetëdeklarimi ose deklarimi me kërkesë, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, bëhet si rregull me shkrim. Deklarimi me shkrim nuk është i domosdoshëm kur deklaramet verbale të zyrtarit janë të regjistrueshme dhe të dokumentueshme sipas procedurave të përcaktuara me ligj dhe/ose në rregulloret e brendshme të institucionit publik ku zyrtari ushtron funksionin.

4. Në çdo rast të shfaqjes së konfliktit të interesit, njësia përgjegjëse në institucionin punëdhënës regjistron në Regjistrin e Konfliktit të Interesit identitetin e zyrtarit publik, interesat private të tij, shkakun për konfliktin e interesit dhe konfliktin e konstatuar, palët e interesuara, burimin e informacionit, si dhe vendimet e marra për parandalimin, trajtimin dhe zgjidhjen e tyre.

Neni 22

Autorizimi i kontrollit

1. Deklarimi i interesave private shoqërohet me një autorizim të veçantë që zyrtari publik dhe personi i lidhur me të duhet të lëshojnë në favor të institucionit publik ku ushtron funksionet, nëpërmjet të cilit ai autorizon këtë institucion dhe/ose ILDKPKI-në të kryejë kontroll dhe të sigurojë të dhëna personale për zyrtarin dhe personin e lidhur me të. Ky autorizim ka të njëjtën vlerë edhe për çdo institucion epror.

2. Mosdhënia apo refuzimi i lëshimit të autorizimit brenda 15 ditëve nga mbarimi i afatit për deklarimin e interesave private përbën shkak ligjor për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës sipas legjislacionit përkatës.



KREU V
KUFIZIMI I INTERESAVE PRIVATE TË
ZYRTARIT PËR PARANDALIMIN
E KONFLIKTIT TË VAZHDUESHËM TË
INTERESIT PËR RASTE TË VEÇANTA

Neni 23
Kufizime të përgjithshme

1. Llojet dhe kufizimet e interesave private të kategorive të zyrtarëve publikë, të përcaktuara në këtë kre, nuk përfshijnë llojet dhe kufizimet e përcaktuara në ligje të tjera për këto kategori zyrtarësh, të zbatuara për të njëjtin qëllim, por në çdo rast zbatohet dispozita që përcakton kufizimin më të rreptë.

2. Nëse për një interes të caktuar privat të zyrtarit publik nuk parashikohet kufi sasior në këtë ligj, por ai përcaktohet në një ligj tjetër, ky kufi sasior zbatohet edhe për efekt të këtij ligji dhe anasjelltas.

3. Kur në ligje të veçanta përcaktohet se zyrtarët publikë nuk mund të kryejnë veprimtari private, kjo nënkupton edhe ndalimin e zotërimit në mënyrë aktive apo dhe të tërthortë të aksioneve ose pjesëve në kapital në shoqëritë tregtare, në atë masë për të cilat ndalohet kjo veprimtari.

4. Në rast se aksionet apo pjesët në kapital janë të regjistruara në emrin e personit të lidhur, ato vlerësohen njëjloj si të jenë të regjistruara në emër të vetë zyrtarit publik. Personit të lidhur i kufizohen të drejtat pasurore në të njëjtën masë dhe mënyrë si në rastin e vetë zyrtarit publik, sipas kufizimeve dhe ndalimeve të vendosura në këtë ligj. Këto kufizime nuk zbatohen për personat e lidhur me personat e lidhur me zyrtarin publik.

Neni 24
Kufizime për deputetin

Gjatë ushtrimit të mandatit deputeti nuk mund:

a) të ushtrojë detyrë tjetër shtetërore përveç asaj të anëtarit të Këshillit të Ministrave;

b) të kryejë veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe as të fitojë pasuri prej tyre;

c) të jetë drejtues ose anëtar i organeve drejtuese të organizatave fitimprurëse;

ç) të jetë i punësuar në një detyrë tjetër me përjashtim të angazhimeve në mësimdhënie, në

fushën e shkencës ose në veprimtari të lejuara nga ligji organik;

d) nuk mund të ushtrojë veprimtari private, që krijon të ardhura në formën e personit fizik tregtar, ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme;

dh) të zotërojë në mënyrë aktive asnjë aksion ose pjesë në kapital të një shoqërie tregtare nëse ajo rezulton me pozitë dominuese në treg.

Neni 25
**Kufizime për anëtarin e Këshillit të
Ministrave dhe zëvendësministrin**

Gjatë ushtrimit të funksionit Kryeministri, zëvendëskryeministri, ministrit dhe zëvendësministrit nuk mund:

a) të jenë drejtues ose anëtarë të organeve drejtuese në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale dhe çdo organizatë tjetër, përjashtuar organizatat politike dhe/ose shtetërore, si dhe në rastet kur një pozicion i tillë diktohet për shkak të funksionit;

b) të ushtrojnë veprimtari private që krijon të ardhura në formën e personit fizik tregtar, ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme;

c) të jenë të punësuar në një detyrë tjetër, me përjashtim të angazhimeve në mësimdhënie ose në fushën e shkencës, të autorizuar sipas legjislacionit në fuqi dhe që nuk pengojnë ushtrimin e funksionit publik;

ç) të zotërojnë në mënyrë aktive aksione ose pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare, pavarësisht nga fusha e veprimtarisë së saj.

Neni 26
**Kufizime për zyrtarë në funksione të larta
kushtetuese dhe ligjore**

Presidenti i Republikës, gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Avokati i Popullit, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë gjatë ushtrimit të funksionit nuk mund:



a) të jenë drejtues ose anëtarë të organeve drejtuese të organizatave fitimprurëse;

b) të ushtrojnë veprimtari private, që krijon të ardhura në formën e personit fizik tregtar, ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme;

c) të jenë të punësuar në një detyrë tjetër, me përjashtim të angazhimeve në mësimdhënie, në fushën e shkencës ose në veprimtari të lejuara nga ligji organik;

ç) të zotërojnë në mënyrë aktive aksione ose pjesë në kapital të një shoqërie tregtare të çdo forme.

Neni 27

Kufizime për gjyqtarët dhe prokurorët

1. Gjyqtarët dhe prokurorët gjatë ushtrimit të funksionit nuk mund:

a) të jenë drejtues ose anëtarë të organeve drejtuese të organizatave jofitimprurëse;

b) të administrojnë, të drejtojnë ose të ushtrojnë ndikim në shoqëritë tregtare ose fitimprurëse, personalisht ose nëpërmjet përfaqësimit;

c) të ushtrojnë veprimtari fitimprurëse si persona fizikë tregtarë ose si pjesëtarë në një shoqëri tregtare të çdo forme;

ç) të zotërojnë në mënyrë aktive aksione ose pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare të çdo forme;

d) të zotërojnë në mënyrë të tërthortë aksione ose pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare të çdo forme nëse shoqëria ka fitime ose të mira nga kontratat publike;

dh) të zotërojnë në mënyrë të tërthortë aksione ose pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare në të cilën veprimtaria e magistratit është e ndaluar për shkak se mund të ndikojë në pavarësinë e tij, krijon konflikt interesi ose krijon përshtypjen që magistrati është i njëanshëm ose i ndikuar;

e) të ushtrojnë veprimtari profesionale, si: avokatë, noterë, ekspertë të licencuar, konsulentë, agjentë, përfaqësues të subjekteve private, si dhe të ushtrojnë funksione si ekspertë në gjykatat vendase ose arbitër në arbitrazhin tregtar;

ë) të jenë të punësuar në një detyrë tjetër ose të ushtrojnë veprimtari publike ose private, me përjashtim të angazhimeve në mësimdhënie ose në fushën e shkencës, të autorizuar sipas legjislacionit në fuqi e që nuk cenon integritetin profesional dhe nuk pengojnë ushtrimin e detyrave zyrtare;

f) të jenë anëtarë, të mbajnë funksione ose të shfaqen publikisht të lidhur me një parti politike, si dhe të angazhohen në veprimtari politike.

2. Kufizimet sipas pikës 1 të këtij neni zbatohen edhe për magistratët e diplomuar, të cilët janë në pritje të emërimit në detyrë.

Neni 28

Kufizime për kryetarin e bashkisë dhe kryetarin e këshillit të qarkut

Kryetari i bashkisë dhe kryetari i këshillit të qarkut nuk mund:

a) të jenë drejtues ose anëtarë të organeve drejtuese në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale dhe në çdo organizatë tjetër, përjashtuar organizatat politike dhe/ose shtetërore, ose kur një pozicion i tillë diktohet për shkak të funksionit;

b) të ushtrojnë veprimtari private, që krijon të ardhura në formën e personit fizik tregtar, ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme;

c) të jenë të punësuar në një detyrë tjetër, me përjashtim të angazhimeve në mësimdhënie, në fushën e shkencës ose në veprimtari të lejuara nga ligji organik;

ç) të zotërojnë në mënyrë aktive aksione ose pjesë në kapital të një shoqërie tregtare, që e ushtron veprimtarinë brenda territorit të juridiksionit të tyre.

Neni 29

Kufizime për anëtarin e organit të autoritetit rregullator

1. Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Zëvendësguvernatori dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të saj, anëtari e kryetari i një enti apo i një autoriteti rregullator, anëtari dhe kryetari i Autoritetit të Mbrojtjes së Konkurrencës, anëtari dhe kryetari i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare nuk mund:

a) të jenë drejtues ose anëtarë të organeve drejtuese të organizatave jofitimprurëse;

b) të ushtrojnë veprimtari private fitimprurëse, si: tregtarë, ortakë, aksionarë ose përfaqësues të një shoqërie tregtare të çdo forme;

c) të jenë të punësuar në një detyrë tjetër, me përjashtim të angazhimeve në mësimdhënie ose në fushën e shkencës, të autorizuar sipas legjislacionit



në fuqi dhe që nuk pengojnë ushtrimin e funksionit publik;

c) të zotërojnë në mënyrë aktive aksione ose pjesë në kapital të një shoqërie tregtare të çdo forme.

2. Anëtar i enteve apo i autoriteteve rregullatore, i cili nuk e ushtron veprimtarinë me kohë të plotë, mund të përjashtohet nga ndalimet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni në rastet kur është parashikuar ndryshe në ligjet e posaçme që rregullojnë veprimtarinë e këtyre organeve.

Neni 30

Kufizime për zyrtarin e administratës tatimore ose doganore

1. Përveç kufizimeve të përcaktuara në nenin 31, pika 1, të këtij ligji, për zyrtarin e administratës doganore dhe tatimore, që merret me mbledhjen e të ardhurave doganore ose tatimore, zbatohen edhe kufizimet e mëposhtme:

a) zyrtari i organit doganor nuk mund të zotërojë në mënyrë aktive aksione ose pjesë të kapitalit në shoqëritë tregtare që kryejnë veprimtari import-eksporti, përfshirë ofrimin e shërbimeve të konsulencës në këtë fushë;

b) zyrtari i organit tatimor nuk mund të zotërojë në mënyrë aktive asnjë aksion ose pjesë në kapital në shoqëritë tregtare, të cilat janë tatimpaguese ose ushtrojnë veprimtari në fushën ose territorin e juridiksionit të degës së tatim-taksave, ku ushtron funksionet ky zyrtar.

Për zyrtarët e organit drejtues qendror, territor i juridiksionit konsiderohet i gjithë territori i Republikës së Shqipërisë.

2. Përcaktimi i kategorisë së zyrtarëve të administratës tatimore dhe doganore, që u nënshtrohen kufizimeve të parashikuara në këtë nen, bëhet me urdhër të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së.

Neni 31

Kufizimet për zyrtarët deklarues dhe zyrtarët jodeklarues

1. Zyrtarët deklarues, të cilët nuk përfshihen në nenet pararendëse në këtë kre, nuk mund:

a) të ushtrojnë veprimtari profesionale për të cilat kërkohet licencim sipas legjislacionit në fuqi, si: avokatia, noteria, përmbartimi gjyqësor publik ose

privat, administrimi i falimentimit, eksperti i licencuar;

b) të jenë të punësuar në një detyrë tjetër me kohë të plotë, përveç rastit kur këto pozicione mbahen për shkak të detyrës së zyrtarit ose përfaqësimit të institucionit publik ku ai ushtron detyrën, sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi;

c) të jenë drejtues ose anëtarë të organeve drejtuese të një shoqërie tregtare, ose organizate jofitimprurëse nëse aktiviteti i tyre bie në fushën e juridiksionit ose të kompetencës së zyrtarit për të vepruar, përveç rastit kur këto pozicione mbahen për shkak të detyrës së zyrtarit ose përfaqësimit të institucionit publik ku ai ushtron detyrën, sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi;

ç) të ushtrojnë veprimtari private që krijon të ardhura si person fizik tregtar ose si ortak në një shoqëri tregtare të çdo forme, nëse kjo veprimtari përputhet ose bie në sferën e juridiksionit të zyrtarit dhe të kompetencës së tij për të vepruar;

d) të zotërojnë në mënyrë aktive aksione ose pjesë në kapitalin e një shoqërie tregtare nëse kjo shoqëri ushtron veprimtari që përputhet ose bie në sferën e juridiksionit të zyrtarit dhe të kompetencës së tij për të vepruar.

2. Për zyrtarin publik të njësisë së qeverisjes vendore, shkronjat “c” dhe “ç”, të pikës 1 të këtij neni, zbatohen vetëm kur veprimtaria e subjekteve të përmendura në to ushtrohet në territorin e juridiksionit të tij.

3. Zyrtarët jodeklarues gjatë ushtrimit të funksioneve publike nuk mund të mbajnë interesa private që bien ndesh me ligje të posaçme, të cilat rregullojnë veprimtarinë e institucioneve publike ku ata ushtrojnë detyrën apo statusin e tyre të punësimit.

Neni 32

Kufizimi i interesave private të personave të lidhur dhe personave të tjerë të lidhur me zyrtarin publik

1. Personi i lidhur dhe personat e tjerë të lidhur me zyrtarin publik nuk mund të ushtrojnë veprimtari si persona fizikë tregtarë apo shoqëri tregtare të çdo forme, nëse veprimtaria përputhet ose pritet me fushën e ushtrimit të veprimtarisë dhe të kompetencës së tij për të vepruar me akte individuale apo normative të nxjerra prej tij, ose kur zyrtari luan rol thelbësor dhe përcaktues në nxjerrjen



e këtyre akteve, të cilat krijojnë pasoja juridike, përfitime ose kosto për këtë tregtar apo shoqëri tregtare, që bashkëpunojnë ose konkurrojnë me personin e lidhur.

2. Ndalimi i parashikuar në pikën 1 të këtij neni nuk zbatohet kur mjeti i vetëm me të cilin ky zyrtar mund të krijojë efektet e mësipërme është një ligj ose një vendim i këshillit të bashkisë, këshillit të qarkut ose një vendim gjyqësor.

Neni 33

Kufizimet e zyrtarit publik pas përfundimit të ushtrimit të funksionit publik

1. Pas përfundimit të ushtrimit të funksionit, zyrtari publik deklarues dhe jodeklarues nuk mund:

a) të punësohen për një periudhë deri në 2 (dy) vjet pas përfundimit të funksionit publik në pozicione drejtuese, menaxheriale ose mbikëqyrëse në institucione publike ose private, si dhe në institucionet e varësisë së tyre, që kanë pasur marrëdhënie me institucionin ku ka ushtruar funksionin publik, nëse gjatë 2 (dy) vjetëve të fundit të ushtrimit të funksionit ka pasur detyra të drejtpërdrejta në mbikëqyrjen ose auditimin e tyre;

b) të lidhin marrëdhënie kontraktore vetë ose nëpërmjet personave të lidhur, ose nëpërmjet personit të besuar me institucionin ku kanë ushtruar funksionin publik, për një periudhë deri në 1 (një) vit nga përfundimi i funksionit publik;

c) të përfaqësojnë palë në çështje që lidhen me institucionin ku kanë ushtruar funksionin publik, vetë ose nëpërmjet personave të lidhur, ose personit të besuar, për një periudhë deri në 1 (një) vit nga përfundimi i funksionit publik.

2. Institucioni publik nuk mund të lidhë marrëdhënie kontraktore me ish-zyrtarin publik ose me persona fizikë ose juridikë, me të cilët ish-zyrtari publik, personat e lidhur me të ose personat e besuar kanë interesa financiare ose menaxheriale, për një periudhë 1-vjeçare nga përfundimi i funksionit publik.

3. Brenda 30 ditëve nga momenti i konstatimit të një situate që bie ndesh me kufizimet e mësipërme, institucioni është i detyruar të kërkojë zgjidhjen e marrëdhënies kontraktore dhe të njoftojë ILDKPKI-në.

4. Shkelja e këtyre kufizimeve përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet sipas parashikimeve të këtij ligji.

5. ILDKPKI-ja, në zbatim të këtij neni, përcakton procedurën, afatet, si dhe mënyrën e raportimit dhe shqyrtimit të angazhimeve profesionale apo marrëdhënieve kontraktore të ish-zyrtarëve publikë.

Neni 34

Përfundime për pjesëmarrjen e zyrtarëve publikë në programe të asistencës teknike, trajnime profesionale dhe veprimtari ndërkombëtare

1. Kufizimet dhe ndalimet e parashikuara në këtë ligj nuk zbatohen për pjesëmarrjen e zyrtarëve publikë në cilësinë e ekspertit, përfaqësuesit institucional, anëtarit të grupeve të punës ose trajnerit, në:

a) programe të asistencës teknike;

b) projekte të bashkëpunimit ndërkombëtar;

c) veprimtari të organizuara nga organizata ndërkombëtare, institucione shtetërore të huaja ose organizata jofitimprurëse të huaja;

ç) programe trajnimi profesional, akademik ose shkencor.

2. Pjesëmarrja në veprimtaritë e parashikuara në pikën 1 të këtij neni lejohet, vetëm kur:

a) është në përputhje me funksionin publik të zyrtarit;

b) nuk krijon konflikt interesi ose përfitim personal të ndaluar nga ky ligj;

c) është e autorizuar paraprakisht nga institucioni ku zyrtari ushtron funksionin;

ç) dokumentohet dhe sigurohet transparencë.

3. Kur pjesëmarrja në këto veprimtari shoqërohet me shpërblym financiar ose përfitime të tjera materiale, zyrtari publik është i detyruar t'i deklarojë ato në përputhje me legjislacionin në fuqi për deklarimin e interesave private dhe rregullat e etikës në ushtrimin e funksionit publik.

4. ILDKPKI-ja nxjerr udhëzimin për parashikimet e këtij neni dhe, kur kërkohet një vlerësim individual i rrethanave të pjesëmarrjes, mund të japë këshillime.



KREU VI
KUFIZIME DHE NDALIME TË
INTERESAVE PRIVATE TË ZYRTARIT
PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT
TË INTERESIT PËR ÇËSHTJE TË VEÇANTA

Neni 35

Ndalimi për të përfituar nga prona publike

1. Presidenti i Republikës, Kryeministri, zëvendëskryeministri, ministri, deputeti, zëvendëskryeministri, anëtar i Gjykatës Kushtetuese, kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, gjyqtari i Gjykatës Lartë, Prokurori i Përgjithshëm, Avokati i Popullit, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe anëtar i organeve drejtuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe asnjë shoqëri tregtare, ortakëri a shoqëri e thjeshtë, ku ky zyrtar zotëron në mënyrë aktive, të tërthortë apo pasive aksione ose pjesë në kapital, në çfarëdo sasi, nuk mund të kryejnë asnjë veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe as të fitojnë pasuri prej tyre.

2. Gjyqtarët dhe prokurorët dhe asnjë shoqëri tregtare, ortakëri ose shoqëri e thjeshtë, ku ky zyrtar zotëron në mënyrë aktive, të tërthortë apo pasive aksione ose pjesë në kapital, në çfarëdo sasi, nuk mund të kryejnë asnjë veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe as të fitojnë pasuri në territorin e juridiksionit të institucionit ku ushtron funksionin gjyqtari ose prokurori.

3. Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, zëvendësguvernatori dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të saj, anëtar i një enti apo të një autoriteti rregullator, anëtar dhe kryetari i Autoritetit të Mbrotjtjes së Konkurrencës, anëtar dhe kryetari i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe çdo shoqëri tregtare, ortakëri ose shoqëri e thjeshtë ku ky zyrtar zotëron në mënyrë aktive, të tërthortë apo pasive aksione ose pjesë në kapital, në çfarëdo sasi, nuk mund të kryejnë asnjë veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe as të fitojnë pasuri në territorin e juridiksionit të institucionit ku punon zyrtari.

Për këta zyrtarë është, gjithashtu, e ndaluar kryerja e veprimtarive fitimprurëse, ku shfaqen si palë, nga njëra anë vetë zyrtari si individ ose person fizik tregtar, si dhe çdo person i lidhur me të, dhe nga ana tjetër operatorët-subjektet tregtare, veprimtaria tregtare e të cilave pritet apo bie në fushën e ushtrimit të veprimtarisë dhe të kompetencës së autoritetit ku ky zyrtar ushtron detyrën.

Zyrtari, nëse do të ndodhet në këto kushte, kërkon gjithnjë paraprakisht moskundërshtimin e entit rregullator përkatës, bazuar në një kërkesë zyrtare dhe të argumentuar. Veprimet administrative bëhen kurdoherë publike nga vetë enti rregullator. Mungesa e një përgjigje brenda 30 ditëve nga ana e entit rregullator konsiderohet moskundërshtim. Për zyrtarët e organit drejtues qendror, territor i juridiksionit vlerësohet i gjithë territori i Republikës së Shqipërisë.

4. Zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas legjislacionit të shërbimit civil apo zyrtarët e barasvlershëm me ta, zyrtari i administratës doganore dhe tatimore, dhe çdo shoqëri tregtare, ortakëri ose shoqëri e thjeshtë, ku ky zyrtar zotëron në mënyrë aktive, të tërthortë apo pasive aksione ose pjesë në kapital, në çfarëdo sasi, nuk mund të kryejnë asnjë veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe as të fitojnë pasuri në territorin e juridiksionit të institucionit ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë. Për zyrtarët e organit drejtues qendror, territor i juridiksionit vlerësohet i gjithë territori i Republikës së Shqipërisë.

5. Zyrtari në funksionin e kryetarit ose të zëvendëskryetarit të bashkisë, të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose zyrtari i qeverisjes vendore, sipas interpretimit të këtij termi në ligjet përkatëse, dhe çdo shoqëri tregtare, ortakëri ose shoqëri e thjeshtë ku ky zyrtar zotëron në mënyrë aktive, të tërthortë apo pasive aksione ose pjesë në kapital, në çfarëdo sasi, nuk mund të kryejnë asnjë veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe as të fitojnë pasuri në territorin e juridiksionit të bashkisë ose këshillit të qarkut ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur aktet ose kontratat administrative kryhen prej një institucioni publik në varësi të kësaj njësie.



6. Zyrtarët deklarues të patrajtuar në pikat e mësipërme dhe zyrtarët jodeklarues, si dhe asnjë shoqëri tregtare, ortakëri ose shoqëri e thjeshtë ku këta zyrtarë zotërojnë në mënyrë aktive, të tërthortë apo pasive aksione ose pjesë në kapital, në çfarëdo sasive, nuk mund të kryejnë asnjë veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe as të fitojnë pasuri në territorin e juridiksionit të institucionit ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

7. Ndalimet dhe kufizimet për zyrtarin të përcaktuara në këtë nen zbatohen në përputhje me pikat e mësipërme të këtij neni edhe për personat e lidhur me zyrtarin. Ndalimet dhe kufizimet e këtij neni nuk zbatohen për personat e lidhur me personat e lidhur me zyrtarin.

8. Pavarësisht përcaktimeve të bëra në këtë nen, ndalohet lidhja e kontratave ndërmjet një institucioni publik apo çdo institucioni publik tjetër të varësisë, nga njëra anë, dhe një individ, personi fizik, shoqëri tregtare, ortakëri ose shoqëri e thjeshtë, nga ana tjetër, kur plotësohen njëkohësisht dy kushtet e mëposhtme:

a) zyrtari publik që ushtron funksionin në këtë institucion publik ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese në vendimmarrjen e procesit të vlerësimit të ofertave ose në përcaktimin e termave të kontratës;

b) zyrtari publik ka interes privat sipas përcaktimeve të nenit 30 të Kodit të Procedurave Administrative apo të nenit 709 të Kodit Civil, ose ka një interes të llojit të përcaktuar në këtë nen.

Neni 36

Akte ose kontrata administrative të posaçme

1. Nga ndalimet e parashikuara në nenin 35 të këtij ligji përjashtohen rastet kur akti ose kontrata administrative:

a) ka të bëjë me punësimin e vetë zyrtarit në institucion publik ose me statusin e tij ligjor;

b) ka të bëjë me marrjen nga zyrtari të një shërbimi që ofrohet nga institucioni publik ose organizmat dhe subjektet e krijuara ose nën kontrollin e institucionit publik, kur këto shërbime janë të parashikuara në objektin e veprimtarisë së institucionit publik, si dhe me kushtin që shërbimi

nuk i jepet zyrtarit në mënyrë favorizuese apo si trajtim preferencial në raport me të tjerët;

c) bazohet në ligj të posaçëm për qëllime publike vetëm kur trajtimi është i përgjithshëm, përfitimi është dytësor dhe proporcional, dhe interesi publik tejkalon qartësisht interesin privat;

ç) është e domosdoshme për ushtrimin e funksionit publik vetëm kur interesi publik tejkalon qartësisht interesin privat, nuk ekziston alternativë tjetër e parashikuar në ligj, akti është proporcional, vendimi është i arsyetuar me shkrim dhe i njoftohet autoritetit përgjegjës sipas ligjit të posaçëm;

d) ka të bëjë me një dhuratë, favor ose trajtim preferencial, në çdo rast pa kundërshtim, që subjektet e përcaktuara në këtë dispozitë bëjnë në favor të një institucioni publik;

dh) është kryer në kushtet e fatkeqësisë natyrore apo gjendjes së jashtëzakonshme;

e) ka të bëjë me veprime administrative të kryera nga shoqëritë ku shtetasit kanë përfituar aksione dhe pjesë në kapital për shkak të punësimit të tyre, kur kjo shoqëri ka qenë institucion publik dhe që është privatizuar me ligj të posaçëm. Përqindja e pjesëmarrjes është nën kufirin 5%.

2. Për rastin përjashtimor të shkronjave “ç” dhe “e”, të pikës 1 të këtij neni, institucioni publik, që kryen akte ose kontrata administrative, sipas ligjeve dhe akteve nënligjore që rregullojnë funksionimin e tij:

a) kërkon pëlqimin e institucionit më të afërt epror;

b) njofton ILDKPKI-në për këto veprime administrative, në mungesë të institucionit epror apo kur marrja e pëlqimit bie ndesh me parimin e pavarësisë së institucioneve.

Neni 37

Ndalime në sigurimin e të ardhurave nga zyrtarët publikë

1. Zyrtarit publik i ndalohet të zotërojë në mënyrë aktive aksione, pjesë në kapital ose përfitime të tjera, që nuk rrjedhin nga zotërimi i tërthortë, në shoqëri tregtare që përfitojnë përjashtime apo lehtësime nga detyrimet doganore ose tatimore, ose që ushtrojnë veprimtari në zona të lira, nëse zyrtari ka kompetenca vendimmarrëse në dhënien e këtyre lehtësirave dhe përjashtimeve ndaj shoqërisë.

2. Zyrtarit publik që përfaqëson një institucion publik në zotërimin e aksioneve ose pjesëve në



kapital të një shoqërie tregtare i ndalohet që gjatë ushtrimit të funksionit:

a) të marrë drejtpërdrejt ose tërthorazi, me ndërmjetësimin e palëve të treta, çdo përfitim financiar, ofertë apo premtim për përfitim, përfshirë krijimin e një burimi të ardhshëm financiar, që lidhet me detyrën e tij si përfaqësues;

b) të pranojë dhurata ose pjesë në kapital në favor të tij nga vetë shoqëria tregtare, anëtarët ose organet e saj;

c) të blejë aksione, pjesë në kapital ose pasuri të shoqërisë, që i janë ofruar apo premtuar;

ç) të përfitojë drejtpërdrejt ose tërthorazi nga furnizues apo klientë të shoqërisë tregtare.

3. Ndalimet dhe kufizimet e parashikuara në këtë nen zbatohen edhe për personat e lidhur me zyrtarin publik. Ndalimet dhe kufizimet e këtij neni nuk zbatohen për personat e tjerë të lidhur me zyrtarin publik.

Neni 38

Ndalimi i pranimi të dhuratave dhe përfitimeve të tjera

1. Zyrtarit publik nuk i lejohet të kërkojë ose të pranojë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë dhurata, sipas përkufizimit në nenin 3, pika 14, të këtij ligji, premtime, favore ose trajtime preferenciale për veten ose për personat e lidhur me të, përfshirë edhe personat e tjerë të lidhur me zyrtarin, që ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në paanësinë e kryerjes së detyrës, apo janë ose duket sikur janë shpërblim për mënyrën e kryerjes së detyrës zyrtare.

2. Pika 1 e këtij neni nuk zbatohet për dhuratat e zakonshme të mikpritjes tradicionale, dhuratat me vlerë simbolike ose të mirësjelljes, të cilat nuk krijojnë dyshime mbi paanshmërinë e zyrtarit.

3. Dhuratat e marra në kuadër të marrëdhënieve protokollare ose ndërinstitutionale nga përfaqësues zyrtarë të huaj bëhen pronë e institucionit publik dhe regjistrohen sipas legjislacionit në fuqi.

4. Zyrtari, të cilit i janë ofruar dhurata, premtime, favore ose trajtime preferenciale, duhet:

a) t'i refuzojë menjëherë ose t'ia kthejë ofruesit nëse janë pranuar pa dijeninë e tij;

b) t'i raportojë menjëherë eprorit ose institucionit më të afërt epror në rast pamundësie për kthim;

c) të përpiqet të identifikojë ofruesin dhe të shmangë kontaktet e panevojshme me të;

ç) të ketë dëshmitarë, nëse është e mundur, kolegët që punojnë me të;

d) të informojë menjëherë eprorin ose institucionin më të afërt epror për rrethanat e rastit dhe identitetin e ofruesit, nëse është i identifikueshëm, si dhe të japë vlerësimin e tij për lidhjen e ngjarjes me ushtrimin e funksionit zyrtar;

dh) të vazhdojë ushtrimin e funksioneve zyrtare në mënyrë të paanshme dhe të mbajë në dijeni eprorin për çdo zhvillim të mëtejshëm;

e) të raportojë rastin pranë organeve kompetente nëse dyshohet se përbën vepër penale.

5. Vlera e dhuratave të lejueshme për të cilat zyrtari nuk ka detyrimin për t'i deklaruar nuk duhet të tejkalojë, veçmas ose së bashku, vlerën 10.000 (dhjetë mijë) lekë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga ligji. Nëse zyrtari ka dyshim për vlerën e dhuratës, ai njofton menjëherë eprorin ose institucionin kompetent që të kryejë vlerësimin e tij.

6. ILDKPKI-ja përcakton modalitetet e administrimit të dhuratave të lejueshme, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi.

7. Institucionet publike në rregulloret e tyre për parandalimin e konfliktit të interesave përcaktojnë rregulla të posaçme për marrjen, regjistrimin dhe administrimin e dhuratave, premtimeve, favoreve ose trajtimeve preferenciale. Për këtë qëllim, ato krijojnë një regjistër të veçantë për dhuratat e marra në emër të institucionit dhe caktojnë njësinë përgjegjëse për administrimin, ruajtjen ose përdorimin e tyre.

KREU VII

MËNYRAT E ZGJIDHJES DHE TRAJTIMI I KONFLIKTIT TË INTERESAVE

Neni 39

Masat për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave

1. Gjatë ushtrimit të funksionit zyrtari publik duhet të parandalojë dhe të zgjidhë paraprakisht dhe në varësi të rrethanave çdo situatë konflikti interesi, në mënyrë të shkallëzuar dhe proporcionale me rëndësinë e saj, duke përdorur një ose më shumë nga mënyrat e mëposhtme:

a) transferimin ose tjetërsimin e interesave private që krijojnë konflikt me funksionin publik;

b) duke u vetëpërgjashtuar paraprakisht nga procesi konkret i vendimarrjes, me përjashtim të



rasteve kur është i pamundur delegimi i kompetencave të zyrtarit tek një zyrtar tjetër për shkak të ligjit apo për shkak të situatës ose në rastet e organit kolegjial, duke mos marrë pjesë në diskutimin dhe votimin e çështjes në konflikt.

c) dorëheqjen nga detyra, funksionet ose angazhimet private që janë në konflikt me funksionin publik;

ç) dorëheqjen nga funksioni publik në rastet e konfliktit të vazhdueshëm të interesit kur ai nuk mund të zgjidhet me mjete të tjera.

2. Zyrtari publik është i detyruar të informojë dhe të dokumentojë plotësisht zgjidhjen e konfliktit të interesit pranë institucionit kompetent, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 40

Masat për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të vazhdueshëm të interesit

1. Për zyrtarët publikë të përcaktuar në nenet 24 deri në 33 të këtij ligji, kur konflikti i vazhdueshëm i interesit nuk zgjidhet sipas masave të parashikuara në nenin 39 të këtij ligji, zyrtari publik është i detyruar:

a) të japë dorëheqjen nga funksionet drejtuese ose nga anëtarësia në organet drejtuese brenda 15 ditëve nga çasti i lindjes së këtij detyrimi;

b) të ndërpresë brenda 30 ditëve ushtrimin e veprimtarive të ndaluara dhe të kërkojë çregjistrimin e tyre sipas legjislacionit në fuqi;

c) të transferojë të drejtat e zotërimit aktiv të aksioneve ose pjesëve në kapital tek një person i besuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

ç) të njoftojë dhe të dokumentojë pranë institucionit kompetent përmbushjen e këtyre detyrimeve, brenda 10 ditëve nga data e realizimit të tyre.

2. Nëse zyrtari heq dorë nga të gjitha të drejtat e pronësisë mbi aksionet ose pjesët në kapital dhe i tjetërsion ato tek një person tjetër, ky i fundit nuk mund të jetë personi i besuar, sipas përcaktimeve në dispozitat e këtij ligji. Zyrtari duhet ta njoftojë dhe ta dokumentojë këtë veprim menjëherë, por jo më vonë se 15 ditë nga kryerja e tij.

3. Transferimi i të drejtave të zotërimit aktiv të aksioneve ose tjetërsimi kryhet sa më parë që të jetë e mundur, por jo më vonë se 2 muaj nga çasti i lindjes së detyrimit. Zyrtari e njofton dhe e dokumenton përmbushjen e këtij detyrimi

menjëherë, por jo më vonë se 15 ditë nga kryerja e këtij veprimi.

4. Në rast moszbatimi të detyrimeve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, zyrtari publik është i detyruar të japë dorëheqjen nga funksioni publik sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 15 ditë nga momenti i konstatimit të moszbatimit.

Neni 41

Detyrimet e personave të lidhur me zyrtarin publik për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesit

1. Personat e lidhur me zyrtarin publik, sipas përcaktimit në këtë ligj, kanë detyrimin të parandalojnë dhe të zgjidhin konfliktet e interesit që lindin nga lidhja e tyre me zyrtarin publik, duke zbatuar këto masa:

a) të transferojnë ose të tjetërsojnë interesat private që krijojnë konflikt me funksionin publik të zyrtarit, brenda 30 ditëve nga çasti i lindjes së këtij detyrimi;

b) të japin dorëheqjen nga funksionet drejtuese ose nga anëtarësia në organet drejtuese të subjekteve që krijojnë konflikt interesi, brenda 15 ditëve nga çasti i lindjes së këtij detyrimi;

c) të ndërpresin ushtrimin e veprimtarive që bien në konflikt me funksionin publik të zyrtarit dhe të kërkojnë çregjistrimin e tyre në përputhje me ligjin, brenda 30 ditëve;

ç) të transferojnë të drejtat e zotërimit aktiv mbi aksionet ose pjesët në kapital tek një person i besuar, brenda 60 ditëve nga çasti i lindjes së detyrimit;

d) të njoftojnë dhe të dokumentojnë pranë ILDKPKI-së përmbushjen e këtyre detyrimeve, brenda 10 ditëve nga realizimi i tyre.

2. Në rast moszbatimi të detyrimeve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni nga personat e lidhur, zyrtari publik është i detyruar të japë dorëheqjen nga funksioni publik sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 15 ditë nga momenti i konstatimit të moszbatimit.



Neni 42

**Trajtimi dhe zgjidhja e konfliktit të interesit
për drejtuesit e institucioneve
dhe organet kushtetuese**

1. Procedurat, kompetencat e eprorëve ose të institucioneve eprorë për trajtimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesit përcaktohen nga:

a) Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi i Procedurës Penale, respektivisht për proceset gjyqësore civile dhe procedimet penale;

b) Kodi i Procedurave Administrative për të gjitha institucionet publike që i nënshtrohen këtij Kodi;

c) ligje të veçanta që rregullojnë veprimtarinë e institucioneve publike ose të drejtat dhe detyrimet e kategorive të ndryshme të zyrtarëve;

ç) Kushtetuta, kur konflikti lidhet me një zyrtar që njësohet ose është anëtar i një organi kushtetues.

2. Procedurat dhe kompetencat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, sipas rastit, përcaktojnë edhe mënyrën se si vetë zyrtari ose personi i lidhur me të, ndaj të cilit janë zbatuar masat për trajtimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesit, mund të ankohet kur e gjykon se këto masa janë marrë në tejkalim të përcaktimeve të këtij ligji.

3. Për Presidentin e Republikës nuk gjejnë zbatim përcaktimet për konfliktin rast për rast të këtij ligji, me përjashtim të rasteve kur ai ushtron funksionet si anëtar i një organi kolegjal, si dhe kur kjo ka të bëjë me një proces gjyqësor ndaj tij.

4. Kur konflikti i interesit lidhet me anëtarët e organeve të parashikuara në Kushtetutë apo me drejtuesin më të lartë të institucionit publik, trajtimi dhe zgjidhja e tij kryhet përkatësisht nga organet kompetente të përcaktuara në Kushtetutë ose institucioni epror, nëse ka të tillë.

5. Për proceset gjyqësore dhe hetimet parlamentare, identifikimi dhe regjistrimi i interesave, sipas fushës së veprimit të këtij ligji, bëhet vetëm për ato veprime që kryhen para dhe jashtë një procesi konkret gjyqësor civil, një procedimi penal ose hetimi parlamentar. Brenda këtij procesi, identifikimi dhe regjistrimi i interesave kryhen sipas rregullave të përcaktuara, sipas rastit, në kodet e procedurave civile dhe penale, si dhe në legjislacionin që rregullon procesin e hetimit parlamentar.

Neni 43

**Transferimi i të drejtave të zotërimit aktiv
në shoqëritë tregtare**

1. Brenda 30 ditëve nga data e zgjedhjes, emërimit ose caktimit në një funksion publik zyrtari publik duhet të transferojë të drejtat e zotërimit mbi aksionet ose pjesët në kapital që zotëron në një shoqëri tregtare tek një person i besuar. Brenda 5 ditëve nga data e këtij transferimi, zyrtari publik duhet të njoftojë me shkrim ILDKPKI-në, duke paraqitur të dhënat e personit të besuar dhe dokumentacionin përkatës të transferimit.

2. Gjatë periudhës në të cilën të drejtat e administrimit ose drejtimit të shoqërisë tregtare janë transferuar tek personi i besuar, zyrtarit publik i ndalohet:

a) të përfaqësojë shoqërinë;

b) të japë informacion, udhëzime ose urdhra;

c) të ushtrojë çdo formë ndikimi në menaxhimin e saj;

ç) të komunikojë me personin e besuar për çështje që lidhen me ushtrimin e këtyre të drejtave.

3. Zyrtari publik ruan të drejtën të informohet për statusin dhe ecurinë ekonomike të shoqërisë tregtare në të cilën zotëron në mënyrë pasive aksione ose pjesë në kapital. Palët kanë të drejtë të zgjidhin marrëveshjen në çdo kohë në përputhje me ligjin.

Zyrtari publik rimerr të drejtat e administrimit dhe drejtimit të shoqërisë tregtare nga personi i besuar kur kushtet që krijuan detyrimin për transferimin e këtyre të drejtave nuk ekzistojnë më, në përputhje me këtë ligj.

KREU VIII

**INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE PËR
PARANDALIMIN DHE ZGJIDHJEN
E KONFLIKTIT TË INTERESAVE DHE
KOMPETENCAT E TYRE**

Neni 44

**Institucionet përgjegjëse për parandalimin,
kontrollin dhe zgjidhjen e konfliktit të
interesave**

1. Institucioni qendror përgjegjës për mbikëqyrjen dhe zbatimin e dispozitave të këtij ligji është Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.



2. Autoriteti ose strukturat përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji në institucionet publike janë:

- a) eprorët e zyrtarëve, titullari i institucionit dhe institucionit epror;
- b) institucionet eprorë;
- c) njësia përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave e miratuar posaçërisht në çdo institucion publik.

3. Institucionet me akte të brendshme parashikojnë dhe zbatojnë rregulla të veçanta për parandalimin e konfliktit të interesit brenda fushëveprimit dhe kompetencave të tyre.

Neni 45

Kompetencat e eprorit të zyrtarit, titullarit të institucionit dhe të institucionit epror

1. Eprori direkt, titullari i institucionit ose institucioni epror merr masat e nevojshme, të përshkallëzuara dhe proporcionale për të shmangur paraprakisht dhe në çdo rast konfliktin e interesit të çdo forme për shkak të zgjedhjes, emërimit apo caktimit të detyrave ose përgjegjësisë të zyrtarit. Këto masa përfshijnë:

a) kufizimin e informacionit të caktuar për zyrtarin ose shmangien e detyrave dhe përgjegjësisë që përbëjnë shkak për shfaqjen e konfliktit të interesit;

b) të mos lejojë që zyrtari të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes;

c) rishikimin ose ndryshimin e detyrave dhe kompetencave të zyrtarit ose transferimin në një detyrë tjetër që mënjanon konfliktin e interesave, për aq sa nuk përcaktohet ndryshe me ligj;

ç) shmangien e emërimit ose të zgjedhjes së zyrtarit në funksione në të cilat ekzistojnë, ose mund të lindin konflikte të interesave;

d) anulimin ose shfuqizimin e një akti të marrë në kushtet e konfliktit faktik të interesave, mundësisht para se ato të kenë sjellë pasoja;

dh) anulimin ose shfuqizimin e një akti, edhe kur çmohet se akti është marrë në kushtet e konfliktit të interesit, i cili mund të shfaqet rast për rast ose në mënyrë të vazhdueshme;

e) anulimi ose shfuqizimi i një akti administrativ nuk bëhet nga eprori apo institucioni epror, kur vlerësohet se pasojat që mund të vijnë nga anulimi ose shfuqizimi i tejkalojnë dukshëm përfitimet nga ky anulim apo shfuqizim. Në këtë rast eprori apo institucioni epror njofton ILDKPKI-në dhe

Avokaturën e Shtetit, brenda 5 ditëve nga konstatimi i rastit;

ë) eprori ose institucioni epror që konstaton lidhjen e një kontrate administrative në kushtet e konfliktit faktik të interesave njofton, brenda 5 ditëve nga konstatimi i rastit, Avokaturën e Shtetit, me qëllim ngritjen e padisë për pavlefshmërinë e saj. Në këtë rast eprori apo institucioni epror njofton edhe ILDKPKI-në.

2. Pavarësisht masave të mësipërme dhe çdo mase tjetër të përcaktuar me ligj, zyrtari ose eprori i tij sipas hierarkisë nuk përjashtohen nga përgjegjësia kur masat e marra nuk japin efekt në parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesit sipas këtij ligji.

3. Eprori direkt, titullari i institucionit ose institucioni epror njoftojnë ILDKPKI-në, brenda 5 ditëve, për marrjen e masave për zgjidhjen e konfliktit të interesit.

4. Kur një akt i një institucioni publik bëhet i pavlefshëm sipas përcaktimeve në ligj:

a) institucioni publik, kur gjykon se zyrtari ka vepruar me keqbesim, brenda 30 ditëve nga njoftimi ndërmerr:

i. procedurat e ecuresë disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës;

ii. mjete ligjore për kalimin e barrës së dëmshpërblimit tek zyrtari përgjegjës;

iii. kërkesën pranë gjykatës edhe dëmshpërblim moral në favor të institucionit për dëmin moral nëpërmjet një padie civile;

iv. kallëzim penal nëse gjykon se shkelja është vepër penale.

Përcaktimet e shkronjës “a” të kësaj pike zbatohen edhe ndaj çdo zyrtari përgjegjës, i cili nuk ka parandaluar konfliktin e interesit për shkak të pavlefshmërisë së aktit ose për moszbatim të detyrimeve sipas shkronjës “a” të kësaj pike;

b) në rastin e deputetit zbatohen procedura dhe masat e parashikuara nga Rregullorja e Kuvendit dhe Kodi i Sjelljes së Deputetit. Në rastin e gjyqtarit për vendimet gjyqësore të marra prej tij ose për votën e tij në një vendim gjyqësor nuk zbatohen shkronjat “ii” dhe “iii”. Në rastin e prokurorit në ushtrimin e detyrës dhe zyrtarë të tjerë që ushtrojnë funksione kontrolli nuk zbatohen shkronjat “ii” dhe “iii”.

5. Institucionet publike gjatë veprimtarisë administrative, kur vihen në dijeni të veprimeve të kryera nga zyrtarët dhe personat e lidhur me ta për të cilët ligji ka vendosur kufizime dhe ndalime, në lidhje me pronën publike, detyrohen t'i pezullojnë



procedurat ligjore dhe të njoftojnë për këtë fakt, brenda 5 ditëve, institucionin publik ku punon zyrtari dhe ILDKPKI-në.

Neni 46

Kompetencat e njësisë përgjegjëse të parandalimit të konfliktit të interesit në institucionet publike

1. Njësia përgjegjëse e parandalimit të konfliktit të interesit në institucionet publike ka këto kompetenca:

a) verifikon dhe kryen hetimin administrativ të deklarimeve të interesave private për zyrtarin publik që mbart detyrimin për deklarim pranë njësisë përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave, për zbatimin e kufizimeve dhe të ndalimeve të interesave private për konfliktin e vazhdueshëm, të mundshëm dhe rast për rast të interesit;

b) verifikon dhe kryen hetimin administrativ për konfliktin rast për rast të interesave private të zyrtarëve kur ata përfshihen në vendimarrje për akte ose kontrata administrative sipas fushës së zbatimit të ligjit;

c) mbledh dhe pranon informacion për interesat private të një zyrtari, përfshirë të dhënat publike ose private, nga burime të ligjshme. Konkreisht nga:

i. regjistrat publikë ose privatë, të mbajtur në përputhje me legjislacionin në fuqi;

ii. të dhënat nga media;

iii. të dhënat ose ankesat nga publiku;

iv. çdo burim tjetër i ligjshëm;

ç) verifikon besueshmërinë e burimeve të informacionit për të vërtetuar konfliktin e interesit;

d) vë në dijeni zyrtarin për informacionin e siguruar për të dhe që përbën shkak për konflikt interesi dhe i jep mundësi të provojë të kundërtën;

dh) njofton me shkrim personin fizik ose juridik dhënë të informacionit, brenda afatit prej 30 ditësh për shqyrtimin e informacionit të dhënë dhe vendimet e marra;

e) njofton me shkrim eprorin e institucionit publik dhe ILDKPKI-në, në lidhje me zyrtarët publikë, që do të rezultojnë se posedojnë interesa private në kundërshtim me kufizimet dhe ndalimet e vendosura në ligj, brenda afatit 30-ditor nga përfundimi i verifikimeve të kryera;

ë) njofton me shkrim eprorin e institucionit publik dhe ILDKPKI-në për zyrtarët publikë që do

të rezultojnë me vendimarrje për veprime administrative të marra në prani të interesave private, brenda afatit 30-ditor nga përfundimi i verifikimeve të kryera;

f) kryen regjistrimin e interesave private të zyrtarëve publikë dhe ndryshimeve në to;

g) kryen regjistrimin e çdo rasti të shfaqjes së një konflikti të interesit në regjistrat e konfliktit të interesit, të cilat miratohen sipas modelit të përcaktuar nga Inspektori i Përgjithshëm.

2. Në përshkrimin e pozicionit të punës së njësisë përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave vendosen kritere edhe për njohjen e ligjeve për deklarimin e pasurive dhe parandalimin e konfliktit të interesit. Për emërimin, lëvizjen apo largimin nga funksioni të të punësuarve në njësinë përgjegjëse të parandalimit të konfliktit të interesave në institucionet publike njoftohet paraprakisht ILDKPKI-ja.

3. Njësia përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave i dorëzon ILDKPKI-së çdo vit për vitin pararendës, por jo më vonë se data 31 janar, një raport për veprimtarinë e kryer në zbatim të këtij ligji, përfshirë rastet e konfliktit të interesave, mënyrat e ndjekura për parandalimin, rezultatet e arritura, si dhe statusin e trajtimit të tyre.

4. Njësia përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave, për veprimtarinë verifikuese të parashikuar në këtë dispozitë, ushtron kontroll brenda 6 muajve nga dorëzimi i deklaratës së konfliktit të interesave ose brenda 6 muajve nga konstatimi i çështjes me konflikt interesi.

5. Njësia përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave në institucionet publike, për efekt të zbatimit të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë“, i ndryshuar, mbledh dhe i dërgon Inspektoratit të Lartë deklaratat e plotësuar të interesave private para fillimit të detyrës, pas largimit nga funksioni, brenda 15 ditëve nga përmbushja e afatit ligjor për dorëzimin e këtyre deklaratave nga subjekti deklarues. Deklaratat periodike vjetore i dërgohen Inspektoratit të Lartë brenda datës 15 prill të çdo viti. Autoritetet përgjegjëse njoftojnë ILDKPKI-në për rastet e mosdeklarimeve.



Neni 47

Kompetencat e ILDKPKI-së

1. ILDKPKI-ja, në cilësinë e institucionit qendror përgjegjës për zbatimin e këtij ligji, ka këto kompetenca:

a) kryen drejtimin dhe përmirësimin e politikave dhe të mekanizmave të parandalimit dhe shmangies së konfliktit të interesave dhe monitoron zbatimin e tyre;

b) ofron ndihmë teknike dhe profesionale për këshillimin dhe mbështetjen e nismave ligjore dhe nënligjore të ndërmarra nga institucionet publike për parandalimin e konfliktit të interesave;

c) ofron rekomandime për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë për vlerësimin e projektligjeve që kanë të bëjnë me çështjen e konfliktit të interesave, kur kërkohet nga ky institucion;

ç) ndihmon në forcimin e kapaciteteve për trajtimin e konfliktit të interesave në institucione dhe merr masa për trajnimin e tyre;

d) monitoron, kontrollon dhe vlerëson përputhshmërinë e akteve nënligjore dhe të rregulloreve të brendshme, të miratuara nga institucionet publike për konfliktin e interesave, me parimet dhe detyrimet e këtij ligji;

dh) monitoron, kontrollon dhe vlerëson zbatimin e këtij ligji në tërësi për parandalimin e konfliktit të interesave në institucionet publike, si dhe të respektimit të këtij ligji në raste të veçanta të konfliktit të interesave;

e) realizon regjistrimin periodik të interesave private të zyrtarëve deklarues;

ë) përcakton modelin e deklarimit të konfliktit të interesave private dhe të autorizimit për kontroll, si dhe të regjistrimit të zyrtarëve publikë për regjistrimin e të dhënave që lidhen me konfliktin e interesit;

f) këshillon zyrtarët, eprorët, institucionet eprore, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave të lidhura me ta, si dhe për regjistrimin periodik dhe rast për rast të interesave, pasi janë shteruar më parë mjetet e brendshme në institucionet publike ose kur gjykohet e nevojshme nga ILDKPKI-ja;

g) verifikon dhe kryen hetimin administrativ të deklarimeve të interesave private për zyrtarët që kanë detyrimin të deklarojnë në ILDKPKI;

gj) verifikon dhe kryen hetimin administrativ të kufizimeve të interesave private për konfliktin e

vazhdueshëm për raste dhe çështje të veçanta të vendosura për zyrtarët që kanë detyrimin të deklarojnë në ILDKPKI;

h) njofton institucionin epror, si dhe Avokaturën e Shtetit të vazhdojnë procedurat e mëtejshme ligjore për anulimin ose shpalljen e pavlefshmërisë së akteve apo kontratave administrative, të cilat pas kontrollit dhe hetimit administrativ të zyrtarit rezultojnë me konflikt interesi, me qëllim rregullimin e pasojave ligjore të shkaktuara prej tyre;

i) monitoron, kontrollon dhe vlerëson zbatimin e këtij ligji nga njësia përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave në institucionet publike, lidhur me rastet e shfaqjes së formave të konfliktit të interesit të përcaktuara në këtë ligj;

j) verifikon dhe kryen hetimin administrativ të konfliktit rast për rast të interesave, si dhe të ndalimeve e kufizimeve të interesave të përcaktuara në ligj me kërkesë të institucionit publik ose epror, kur e gjykon të nevojshme edhe me nismën e tij, ose u kërkon institucioneve përgjegjëse pranë institucionit publik për të kryer verifikimin dhe hetimin e rastit;

k) vendos masa administrative ndëshkuese në kompetencë të saj sipas përcaktimeve në këtë ligj;

2. ILDKPKI-ja administron, përditëson dhe mirëmban regjistrin e zyrtarëve publikë deklarues sipas përcaktimeve të këtij ligji.

3. Për verifikimin dhe hetimin administrativ të deklaratave të interesave private, ILDKPKI-ja ka të drejtë të shfrytëzojë të dhënat e nevojshme në të gjithë administratën shtetërore dhe publike, dhe te personat juridikë publikë e privatë, të cilët detyrohen të vënë në dispozicion të dhënat e kërkuara nga ILDKPKI-ja, jo më vonë se 15 ditë pas paraqitjes së kërkesës.

4. Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, në zbatim të përgjegjësisë dhe kompetencave në këtë ligj, nxjerr urdhra, udhëzime dhe akte të tjera administrative, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

5. Mbi bazën e raportit vjetor, Inspektori i Përgjithshëm harton vlerësime dhe rekomandime për zbatimin e këtij ligji nga njësia përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesit në institucionet publike.



KREU IX
PROCEDURA ADMINISTRATIVE PËR
VERIFIKIMIN E KONFLIKTIT
TË INTERESIT DHE PËR RREGULLIMIN
E PASOJAVE TË SHKAKTUARA
NGA KONFLIKTI I INTERESAVE

Neni 48

**Procedura administrative nga institucionet
përgjegjëse për verifikimin e konfliktit
të interesit dhe për rregullimin e pasojave
të shkaktuara nga konflikti i interesit**

1. Procedura administrative për verifikimin e konfliktit të interesit dhe për rregullimin e pasojave të shkaktuara nga konflikti i interesit, fillon:

- a) me kërkesën e zyrtarit;
- b) kryesisht, respektivisht, nga ILDKPKI-ja ose institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji;
- c) në bazë të informacionit të marrë nga burime të ligjshme, përfshirë informacionin anonim;
- ç) në rastet e tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

2. Procedura hetimore administrative e zhvilluar nga ILDKPKI-ja ose nga institucionet publike përgjegjëse për verifikimin e konfliktit të interesit dhe për rregullimin e pasojave të shkaktuara nga konflikti i interesit mbështetet në Kodin e Procedurave Administrative dhe në këtë ligj, dhe është konfidenciale.

3. Institucionet përgjegjëse, në bazë të kompetencave të dhëna nga ky ligj, kur marrin dijeni për konfliktin e mundshëm të interesit, fillojnë menjëherë procedurën administrative për verifikimin dhe vërtetimin e konfliktit të mundshëm të interesit, dhe rregullimin e pasojave të shkaktuara prej tij.

4. Procedura administrative për zyrtarët dhe që lidhet me konfliktin e vazhdueshëm të interesit, dhe të çështjeve të veçanta, kryhet nga ILDKPKI-ja ose nga institucionet publike përgjegjëse, përjashtuar rastet kur me ligj është parashikuar ndryshe dhe që lidhet me disa funksione dhe procese ligjore, sipas parashikimeve të bëra në këtë ligj.

5. Procedura administrative në rastet e zyrtarëve për konfliktin rast për rast dhe që lidhet me një vendimmarrje kryhet nga institucionet përgjegjëse në institucionin publik, sipas parashikimeve të bëra në ligj. Mekanizmat e kontrollit dhe të verifikimit të

brendshëm nuk cenojnë kompetencën e përgjithshme të verifikimit të ILDKPKI-së.

6. Procedura administrative për verifikimin dhe vërtetimin e akteve ose kontratave administrative të kryera, që mund të sjellin ekzistencën e konfliktit të interesit, kryhet nga institucionet publike pranë të cilave është i punësuar zyrtari ose nga institucionet e tjera publike që verifikojnë apo kontrollojnë këto veprime administrative sipas legjislacionit në fuqi. Institucioni publik që kryen hetimin administrativ anulon ose shfuqizon aktet ose kontratat administrative të kryera në mënyrë të arsyetuar, bazuar në Kodin e Procedurave Administrative.

7. Institucioni publik që anulon ose shfuqizon aktin ose kontratën administrative, të marrë në kushtet e konfliktit të interesave, ndërmerr hapat e nevojshëm për rregullimin e pasojave juridike. Nëse institucioni publik e ka të pamundur objektivisht rregullimin e pasojave juridike, njofton Avokaturën e Shtetit për të vijuar me rregullimin e pasojave juridike, duke iu drejtuar me kërkesë-padi gjykatës kompetente.

8. Institucioni publik që konstaton akte ose kontrata administrative të marra në kushtet e konfliktit të interesave njofton zyrtarisht me shkrim ILDKPKI-në për veprimet hetimore të kryera brenda 15 ditëve nga kryerja e veprimit të fundit hetimor-administrativ, së bashku me një vlerësim përfundimtar për masën administrative që vlerësohet se duhet të aplikohet. Në këto raste, ILDKPKI-ja vlerëson përmbushjen e kushteve për marrjen e masave administrative dhe vendos për llojin e masës administrative që duhet zbatuar.

9. Procedurat për marrjen e masave administrative dhe ankimi ndaj tyre rregullohen sipas këtij ligji dhe Kodit të Procedurave Administrative.

KREU X
SANKSIONET

Neni 49
Të përgjithshme

Trajtimet dhe zgjidhjet e konfliktit të interesave, sipas parashikimeve të këtij ligji, nuk vlerësohen si sanksione sipas këtij kreu.



Neni 50

Kundërvajtjet administrative

1. Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe ndëshkohet me gjobë, si më poshtë:

a) për shkelje të detyrimit në afat dhe pa shkaqe të arsyeshme, të përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të nenit 20 të këtij ligji, zyrtari publik dhe/ose personi i lidhur me zyrtarin publik dënohen me gjobë nga 200.000 lekë deri në 500.000 lekë;

b) për shkelje të detyrimit, të përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3, të nenit 21 të këtij ligji, zyrtari publik dënohet me gjobë nga 200.000 lekë deri në 500.000 lekë;

c) për shkelje të detyrimit, të përcaktuar në pikën 4, të nenit 21 të këtij ligji, njësia përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave dënohet me gjobë nga 200.000 lekë deri 500.000 lekë;

ç) për shkelje të detyrimit, të përcaktuar në nenin 22 të këtij ligji, zyrtari dhe/ose personi i lidhur dënohen me gjobë nga 200.000 lekë deri në 500.000 lekë;

d) për shkelje të detyrimit, të përcaktuara në nenet 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30 dhe 31 të këtij ligji, zyrtari dhe/ose personi i lidhur dënohen me gjobë nga 200.000 lekë deri në 500.000 lekë;

dh) për shkelje të detyrimit, të përcaktuara në nenin 32 të këtij ligji, zyrtari, personi i lidhur me zyrtarin publik, personi i besuar, drejtuesi i shoqërisë dënohen me gjobë nga 200.000 lekë deri në 500.000 lekë;

e) për shkelje të detyrimit, të përcaktuara në pikat 2 dhe 4, të nenit 33 të këtij ligji, njësia përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave dënohet me gjobë nga 200 000 lekë deri në 500 000 lekë;

ë) për shkelje të detyrimit në afat dhe pa shkaqe të arsyeshme, të përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të nenit 33 të këtij ligji, zyrtari publik dënohet me gjobë nga 200.000 lekë deri në 500.000 lekë;

f) për shkelje të detyrimit, të përcaktuara në nenin 35 të këtij ligji, zyrtari, personi i lidhur, personi i besuar, drejtuesi i shoqërisë dënohen me gjobë nga 200.000 lekë deri në 500.000 lekë;

g) për shkelje të detyrimit, të përcaktuara në nenin 36 të këtij ligji, zyrtari, personi i lidhur me zyrtarin publik, personi i besuar, drejtuesi i shoqërisë dënohen me gjobë nga 200.000 lekë deri në 500.000 lekë;

gj) për shkelje të detyrimit, të përcaktuara në nenin 37 të këtij ligji, zyrtari dhe/ose personi i lidhur me zyrtarin publik dënohen me gjobë nga 200.000 lekë deri në 500.000 lekë;

h) për shkelje të detyrimit, të përcaktuara në nenin 39 të këtij ligji, zyrtari dhe/ose personi i lidhur me zyrtarin publik dënohen me gjobë nga 200.000 lekë deri në 500.000 lekë;

i) për shkelje të detyrimit, të përcaktuara në nenin 43 të këtij ligji, zyrtari dhe/ose personi i lidhur me zyrtarin publik dënohen me gjobë nga 200.000 lekë deri në 500.000 lekë;

j) për shkelje të detyrimit, të përcaktuara në nenin 45 të këtij ligji, eprori i zyrtarit publik dhe/ose institucionit epror dhe/ose titullari i institucionit publik dënohen me gjobë nga 200.000 lekë deri në 500.000 lekë;

k) për shkelje të detyrimit, të përcaktuara në nenin 46 të këtij ligji, njësia përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave dënohet me gjobë nga 200.000 lekë deri në 500.000 lekë;

l) kur nuk jepen pa arsye dhe në afatin e caktuar të dhënata e kërkuara nga ILDKPKI-ja, sipas nenit 47, pika 3, të këtij ligji, personat përgjegjës të institucioneve dhe personave juridikë publikë dhe privatë dënohen me gjobë nga 200.000 lekë deri 500.000 lekë;

ll) për shkelje të detyrimit, të përcaktuara në pikën 3, të nenit 53 të këtij ligji, titullari i institucionit dhe/ose njësia përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave dënohen me gjobë nga 200.000 lekë deri 500.000 lekë;

m) për shkelje të detyrimit, në afat dhe pa shkaqe të arsyeshme, të përcaktuara në nenin 54 të këtij ligji, zyrtari publik dënohet me gjobë nga 200.000 lekë deri 500.000 lekë.

2. Gjobat vendosen nga Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, në rast se shkelja e tyre verifikohet drejtpërsëdrejti prej këtij institucioni ose me propozimin e autoritetit përgjegjës në institucione për çështjet e konfliktit të interesave, apo të shkeljes së detyrimeve pas përfundimit të ushtrimit të funksionit publik, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj.

3. Modalitetet dhe procedura e bashkëpunimit mes ILDKPKI-së dhe autoriteteve përgjegjëse në institucione për zbatimin e kësaj dispozite përcaktohen me udhëzim të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së.



4. Gjodat paguhen nga kundërvajtësi dhe derdhen në buxhetin e ILDKPKI-së jo më vonë se 30 ditë nga komunikimi i gjodës. Me kalimin e këtij afati gjoda përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga punëdhënësi kur kundërvajtësi është në marrëdhënie pune ose nga zyra e përmbarimit me kërkesë të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së.

5. Procedurat për zbatimin e masave administrative dhe ankimimin ndaj tyre rregullohen sipas Kodit të Procedurave Administrative dhe legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative, dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

6. Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative të konstatuara gjatë kryerjes së inspektimeve apo hetimit administrativ të ILDKPKI-së bëhet jo më vonë se 6 muaj pas konstatimit të shkeljes, bazuar edhe në Kodin e Procedurave Administrative.

Neni 51

Ekzekutimi i gjodave

Të ardhurat nga gjodat dhe të ardhurat e tjera të mbledhura në zbatim të dispozitave të këtij ligji kalojnë të gjitha në buxhetin e shtetit, jo më vonë se 30 ditë nga komunikimi i gjodës.

Me kalimin e këtij afati, vendimi i dhënë shndërrohet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga punëdhënësi kur kundërvajtësi është në marrëdhënie pune ose nga zyra e përmbarimit, me kërkesën e Inspektorit të Përgjithshëm.

Neni 52

Përgjegjësitë e tjera ligjore

1. Deklarata për konfliktin e interesit dhe të gjitha dokumentet që i shoqërojnë ato janë dokumente zyrtare. Paraqitja e të dhënave të rreme përbën vepër penale dhe dënohet sipas legjislacionit penal në fuqi.

2. Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj nga zyrtarët përbën shkelje disiplinore, pavarësisht nga përgjegjësia penale apo administrative. Masat disiplinore zbatohen në përputhje me ligjet që rregullojnë marrëdhëniet e punës dhe/ose statusin e zyrtarëve. Për masat disiplinore të marra nga institucionet përkatëse njoftohet rast pas rasti Inspektorati i Lartë.

3. Për zyrtarët që njësohen ose janë anëtarë të organeve kushtetuese zbatohen masat dhe procedurat e përcaktuara nga Kushtetuta dhe dispozitat ligjore përkatëse.

4. Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së për shkeljet e kryera nga anëtarët e njësisë përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave në institucionet publike sipas nenit 39 të këtij ligji i propozon titullarit të institucionit ose institucionit epror largimin nga funksioni të këtij anëtar.

5. Dispozitat e këtij ligji nuk përjashtojnë përgjegjësinë disiplinore dhe penale të zyrtarit sipas legjislacionit të posaçëm në fuqi.

6. ILDKPKI-ja, çdo zyrtar, epror direkt i zyrtarit ose institucioni epror paraqesin kallëzim penal në prokurorinë kompetente ndaj zyrtarit që shkel detyrimet e përcaktuara në këtë ligj dhe që përbëjnë vepër penale sipas Kodit Penal. Nëse ndaj zyrtarit publik është ngritur kallëzim penal, procedurat administrative që lidhen me atë çështje pezullohen deri në përfundimin e procesit penal.

KREU XI

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 53

Aktet nënligjore

1. Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, miraton aktet nënligjore në zbatim të nenit 30, pika 2, nenit 33, pika 5, nenit 34, pika 4, nenit 38, pika 6, nenit 47, nenit 50, pika 3, dhe nenit 54 të këtij ligji.

2. Titullarët e institucioneve, me propozim të njësisë përgjegjëse të parandalimit të konfliktit të interesave, miratojnë brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit rregulloren për parandalimin dhe trajtimin e konfliktit të interesit, përfshirë edhe institucionet nën varësinë e tyre.

3. Aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të këtij neni publikohen përkatësisht në faqen zyrtare të ILDKPKI-së dhe institucioneve përgjegjëse.

Neni 54

Deklarimi i konfliktit të interesave nga zyrtarët me hyrjen në fuqi të ligjit

Zyrtarët publikë plotësojnë formularin e deklarimit të interesave private dhe autorizimin përkatës dhe e depozitojnë atë në ILDKPKI ose në



njësinë përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave në institucionet publike, brenda 30 ditëve nga miratimi i formës dhe përmbajtjes së tyre nga Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së.

Neni 55
Shfuqizim

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Neni 56
Dispozita tranzitore

Të gjitha procedurat e nisura përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji do të trajtohen dhe do të zgjidhen në bazë të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

Neni 57
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 3.2.2026.

Shpallur me dekretin nr. 87, datë 19.2.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 87, datë 19.2.2026
PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 23/2026, “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 88, datë 20.2.2026

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Marco Roberto Casamonti

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 89, datë 20.2.2026

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Bujar Bedredin Pllana



Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 90, datë 20.2.2026

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Yoel Noach Har Even

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 91, datë 20.2.2026

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Manik Mohammad Rabiul Alam Dolar

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 92, datë 20.2.2026

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetas:

1. Burbuqe Ramiz Këpuska

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

**DEKRET****Nr. 93, datë 20.2.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetas:

1. Elmedina Burhan Vorpsi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 94, datë 20.2.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Muhammad Naeem Muhammad Mukarram Uddin

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 95, datë 20.2.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetas:

1. Anastasiya Valeri Haxhiraj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

UDHËZIM**Nr. 3, datë 18.2.2026****PËR ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN
E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË
NXËNËSVE NË ARSIMIN FILLOR,
VITI SHKOLLOR 2025–2026**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 26 dhe pikës 3, të nenit 50, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe urdhrit nr. 578, datë 11.11.2025, të ministrit të Arsimit “Për delegimin e kompetencave



dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit, znj. Orjana Osmani”,

UDHËZOJ:

1. Zhvillimin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve në arsimin fillor më datë 21 maj 2026, për të gjithë nxënësit e klasave të pesta.

2. Testi është i integruar dhe përmban njohuri nga lëndët gjuhë shqipe, matematikë dhe dituri natyre, bazuar në programin orientues për Vlerësimin e Arritjeve të Nxënësve në Arsimin Fillor, përgatitur nga ASCAP-i.

3. Për nxënësit e pakicave kombëtare greke dhe maqedonase pjesa e testit që përfshin njohuri nga lëndët e matematikës dhe të diturisë së natyrës të jetë në gjuhën e tyre amtare.

4. Vlerësimi i arritjeve të nxënësve në arsimin fillor, fillon në orën 10.00 dhe zgjat 1 orë e 30 minuta.

5. Nxënësi duhet të paraqitet 1 (një) orë përpara në qendrën ku zhvillohet vlerësimi.

6. Procedurat e hartimit dhe të vlerësimit të testit përcaktohen në rregulloren “Për procedurat e organizimit dhe të zhvillimit të vlerësimit të arritjeve të nxënësve në arsimin fillor”, miratuar me urdhrin nr. 66, datë 13.2.2024, të ministrit të Arsimit dhe Sportit.

7. Qendra Burimore “Ramazan Kabashi”, tërheq testin në Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QShA), një ditë para zhvillimit të vlerësimit dhe e kthen atë në sistemin e shkrimit *Brail*.

8. Nxënësit me aftësi të kufizuara e zhvillojnë vlerësimin e arritjeve në përshtatje me planin edukativ individual me të cilin punojnë, veçoritë dhe nevojat e tyre, sipas përcaktimeve të rregullores “Për procedurat e organizimit dhe të zhvillimit të vlerësimit të arritjeve të nxënësve në arsimin fillor”, miratuar me urdhrin nr. 66, datë 13.2.2024, të ministrit të Arsimit dhe Sportit.

9. Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP) monitoron procesin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve në arsimin fillor dhe raporton për çdo parregullsi të vërejtur gjatë zhvillimit të tij.

10. Arkivimi i testeve bëhet pranë Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar.

11. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar merr nga Qendra e Vlerësimit të Testit dhe ruan të dhënat e çdo nxënësi, të vlerësuesve të jashtëm dhe të mjediseve ku është realizuar vlerësimi i arritjeve të

nxënësve në arsimin fillor. Këto të dhëna dërgohen në QShA, në AKAP dhe në Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar.

12. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT
Orjana Osmani

URDHËR
Nr. 47, datë 19.2.2026

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës; të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.12.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të ministrit të Financave, zëvendësministrit të Financave, z. Andi Memeti, nga data 23.2.2026 deri në datën 24.2.2026.

2. Ngarkohet zëvendësministri i Financave, z. Andi Memeti, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
Petrit Malaj



URDHËR

Nr. 157, datë 17.2.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E HOLANDËS**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- d) materialit biologjik të shpendëve;
- e) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- f) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Holandës, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2*
1.	Drenthe	Aa en Hunze*
2.	Gelderland	Barneveld*
3.	Gelderland	Kesteren*
4.	Gelderland	Hummelo en Keppel*
5.	Flevoland	Noordoostpolder*
6.	Friesland	Achtkarspelen*
7.	Gelderland	Ede*
8.	Flevoland	Dronten*
9.	Noord-Holland	Beverwijk*
10.	Groningen	Delfzijl*
11.	Zuid-Holland	Dordrecht*
12.	Zeeland	Hulst*
13.	Limburg	Meerlo-Wanssum*
14.	Limburg	Helden*
15.	Overijssel	Wierden*
16.	Flevoland	Zeewolde*
17.	Gelderland	Nijkerk*
18.	Gelderland	Harderwijk*
19.	Drenthe	Coevorden*
20.	Gelderland	Ermelo*
21.	Noord-Brabant	Woudrichem*

22.	Limburg	Venray*
23.	Noord-Brabant	Deurne*
24.	Noord-Brabant	Oisterwijk*
25.	Zuid-Holland	Maasland*
26.	Gelderland	Buren*
27.	Overijssel	Almelo*
28.	Groningen	Stadskanaal*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara, sipas pikës 2 të këtij urdhri.

7. Urdhri nr. 79, datë 27.1.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Holandës”, shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri



URDHËR

Nr. 158, datë 17.2.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETET E BASHKUARA
TË AMERIKËS**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- d) materialit biologjik të shpendëve;
- e) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2
1.	South Dakota	South Dakota*
2.	Kern	Kern*
3.	Pennsylvania	Lancaster*
4.	Illinois	Saint Clair*
5.	Indiana	LaGrange*
6.	Maryland	Caroline*
7.	Kansas	Grant*
8.	Colorado	Weld*
9.	North Carolina	Sampson*
10.	Kansas	Anderson*
11.	Idaho	Latah*
12.	Minnesota	Swift*
13.	South Dakota	Edmunds*
14.	Minnesota	Stearns*
15.	Georgia	Walker*
16.	North Carolina	Wayne*
17.	Minnesota	Meeker*
18.	New Jersey	Burlington*

19.	Montana	Carbon*
20.	Iowa	Kossuth*
21.	Minnesota	Waseca*
22.	Maryland	Queen Anne's*
23.	California	Sonoma*
24.	Kansas	Pratt*
25.	Delaware	Kent*
26.	Colorado	Logan*
27.	Kentucky	Jessamine*
28.	California	Butte*
29.	Texas	Shelby*
30.	Kansas	Pottawatomie*
31.	Missouri	Texas*
32.	Kansas	Nemaha*
33.	Arkansas	Prairie*
34.	Arkansas	Drew*
35.	Kansas	Jewell*
36.	Florida	Volusia*
37.	Indiana	Elkhart*
38.	Indiana	Noble*
39.	Tennessee	Obion*
40.	Kansas	Smith*
41.	Vermont	Orleans*
42.	Minnesota	Becker*
43.	North Dakota	Richland*
44.	Washington	Lewis*
45.	North Dakota	Stutsman*
46.	Minnesota	Le Sueur*
47.	Washington	Snohomish*
48.	Idaho	Payette*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Certifikata veterinarë garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informon të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve



të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara, sipas pikës 2 të këtij urdhri.

7. Urdhri nr. 926, datë 25.9.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës”, shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 159, datë 17.2.2026

**PËR SHFUQIZIMIN E URDHËRIT NR. 49,
DATË 14.1.2026, “PËR DISA MASA
MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES
SË INFLUENCËS AVIARE ME
PATOGENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR
NË SHETËTIN E SPANJËS”**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, pikës 3, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 49, datë 14.1.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Spanjës”.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i

Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

VENDIM
Nr. 41, datë 11.2.2026

**MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË
SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE
NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË
FUNDIT PËR MUAJIN JANAR 2026, PËR
KLIENTËT E LIDHUR NË NIVELIN
E TENSIONIT 35 kV**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar me vendimin nr. 144, datë 25.6.2018 dhe nr. 233, datë 20.12.2019; dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.2.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 540/1 prot., datë 9.2.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin janar 2026, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV”,

konstatoi se:

I. Aspektet ligjore dhe procedurale

1. Paraqitja e kërkesës nga “FSHU” sh.a.

- Shoqëria “FSHU” sh.a., me shkresën nr. 584 prot., datë 2.2.2026, protokolluar në ERE me nr. 540 prot., datë 5.2.2026, ka depozituar kërkesën mbi miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin janar 2026, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.



2. Procesi i shqyrtimit të dokumentacionit nga ERE

Kërkesa është shqyrtuar në përputhje me nenin 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, si dhe në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe “Metodologjisë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar.

II. Analiza e përlogaritjes së çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin janar 2025, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV

1. Blerja e energjisë në bursë

Për muajin janar 2026, shoqëria “FSHU” sh.a. ka siguruar sasinë e energjisë elektrike për mbulimin e kërkesës për energji të kësaj kategorie klientësh nëpërmjet blerjeve ditore/mujore në Bursën Shqiptare të Energjisë (ALPEX).

2. Përlogaritja e çmimit mesatar të ponderuar të blerjes (ÇBEt)

Referuar të dhënave të paraqitura, rezulton se çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike (ÇBEt) i përlogaritur nga shoqëria për muajin janar 2026 është 9.30 lekë/kWh. Për efekt kontrolli të të dhënave të paraqitura, u konsiderua e arsyeshme rillogaritja e tyre, nga e cila rezultoi se mesatarja e ponderuar e çmimit të blerjes së energjisë elektrike është 9.30 lekë/kWh, sikurse

pasqyruar edhe në përlogaritjet e përcjella nga vetë shoqëria.

3. Komponentët sipas metodologjisë (neni 8, i vendimit nr. 201, datë 4.12.2017, i ndryshuar)

Në përputhje me metodologjinë përkatëse, komponentët e përdorur për përlogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike janë, si më poshtë:

- Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike (ÇBEt) për muajin janar 2026: 9.30 lekë/kWh;

- Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 1 janar 2025–31 dhjetor 2027, e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 279, datë 16.12.2024: 0.85 lekë/kWh;

- Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 35 kV, sipas vendimit të Bordit të ERE-s nr. 288, datë 23.12.2024, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.4.2022”: 1.55 lekë/kWh;

- Kostot administrative: 1.06 lekë/kWh;

- Kurset zyrtare të këmbimit të publikuara nga Banka e Shqipërisë (lekë/euro), për çdo datë respektive të harkut kohor 31.12.2025–30.1.2026.

- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, referuar aplikimit të “FSHU” sh.a., si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin janar 2026, përlogaritet, si më poshtë:

Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin janar 2026

		Njësia	Çmimi
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike	Lekë/kWh	9.30
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Lekë/kWh	0.28
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Lekë/kWh	1.06
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Lekë/kWh	0.85
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Lekë/kWh	1.55
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr * CBEt + TRr + TSHt + CA		Lekë/kWh	13.04



- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse, si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se:

- Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit rezulton 13.04 lekë/kwh për muajin janar 2026.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin janar 2026 prej 13.04 lekë/kwh, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

2. Ndryshimi i secilit element përbërës në llogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për kategorinë e klientëve të cilësuar në këtë vendim, do të përbëjë shkak për rishikimin e këtij vendimi nga Bordi i ERE-s.

3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 42, datë 11.2.2026

MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “INFO-TELECOM” SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika

1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e”, 13 dhe 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.2.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 133/7 prot., datë 10.2.2026, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘INFO-Telecom’ sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “INFO-Telecom” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 147, datë 24.6.2021, me afat licence deri më 24.6.2026.

- Shoqëria ka paraqitur kërkesën për rinovimin e kësaj licence brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 8, datë 15.1.2026, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 491, seria T21, të shoqërisë “INFO-Telecom” sh.p.k., për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 147, datë 24.6.2021.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 16.1.2026 dhe 17.1.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 26.1.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Gjithashtu, njoftimi për fillimin e procedurës u botua në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- ERE, me shkresën nr. 133/2 prot., datë 22.1.2026 dhe *email*-in nr. 133/5 prot., datë 6.2.2026, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës dhe i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet për këtë aplikim.

- Me shkresat e protokolluara në ERE nr. 133/3 prot., datë 2.2.2026 dhe nr. 133/5 prot., datë 6.2.2026, shoqëria ka depozituar informacionin/dokumentacionin e munguar të aplikimit.



- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi, rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e nevojshëm për këtë aplikim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën nr. 491, seria T21, të shoqërisë “INFO-Telecom” sh.p.k. për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 147, datë 24.6.2021, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 25.6.2026.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “INFO-Telecom” sh.p.k., “OST” sh.a., “OSSH” sh.a. dhe “ALPEX” sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 43, datë 11.2.2026

MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË SHOQËRISË “NOVA SOLAR SYSTEM” SHPK SI MJET PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ RAIFFEISEN BANK SHA

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 9, pika 8, dhe 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon

interesat e të licencuarit, si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.2.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 54/5 prot., datë 10.2.2026, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Nova Solar System’ sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj të tretëve”,

konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënien e autorizimit për shoqërinë “Nova Solar System” sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Kërkesa për marrjen e autorizimit

- Shoqëria, me shkresën nr. 3109 prot., datë 22.12.2025, ka paraqitur aplikimin dhe dokumentacionin për marrjen e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave si mjet për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj palës kredidhënëse “Raiffesisen Bank” sh.a.

2. Shqyrtimi i kërkesës dhe kërkesa për dokumentacion plotësues

- Shoqëria “Nova Solar System” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 242, datë 3.8.2023, të ndryshuar.

- ERE, me shkresën nr. 54 prot., datë 8.1.2026, email-in e datës 21.1.2026, të protokolluar në vijim me nr. 54/1 prot., datë 21.1.2026 dhe shkresën nr. 54/3 prot., datë 27.1.2026, ka njoftuar shoqërinë, duke i evidentuar depozitimin e informacionit/dokumentacionit të konstatuar të munguar.

3. Dorëzimi i dokumentacionit plotësues

- Shoqëria, nëpërmjet shkresave nr. 54/2 prot., datë 22.1.2026 dhe nr. 54/4 prot., datë 2.2.2026, ka përcjellë informacionin/dokumentacionin e munguar.

4. Përfundime dhe kërkesa të tjera për dhënien e autorizimit

- Nga analiza përfundimtare e dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria “Nova Solar System” sh.p.k., rezulton se është dorëzuar dokumentacioni, në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenet 5,



6, 7 dhe 8, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit, si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2022, si vijon:

- Neni 5, pika 2 – Kërkesa dhe dokumentet shoqëruese janë nënshkruar nga administratori i shoqërisë, në përputhje me kërkesat e rregullores.

Plotësimi i kërkesave të nenit 5:

- Neni 5, pika 4 – Dokumentacioni është paraqitur në gjuhën shqipe, në format origjinal ose të noterizuar dhe i shoqëruar me kopje elektronike;

- Neni 5, pika 5 – Shoqëria ka bërë me dije se, nuk ka pjesë të dokumentacionit të këtij aplikimi që konsideron se nuk duhet të jetë e hapur për publikun.

5. Plotësimi i kërkesës sipas nenit 8:

- Pika 1 – Janë paraqitur të gjitha të dhënat e kërkuara mbi shoqërinë, përfaqësuesin e autorizuar, arsyet për vendosjen e barrës siguruese, përshkrimi i detyrimeve dhe deklarata mbi statusin e kuotave;

- Pika 2 – Janë dorëzuar të gjitha dokumentet përkatëse, përfshirë ekstraktin historik të regjistrit tregtar, vendimet e organeve drejtuese, marrëveshjen përkatëse dhe dokumentacionin tjetër shtetëror, si më poshtë vijon:

- germa “a” – ekstrakti historik i regjistrit tregtar;

- germa “b” – vendimi i organeve drejtuese: ka depozituar vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë “Nova Solar System” sh.p.k., me anë të së cilës është shprehur dakordësia mbi vendosjen e kuotave të kësaj shoqërie si garanci për shlyerjen e detyrimit ndaj “Raiffeisen Bank” sh.a.;

- germa “c” – marrëveshjet përkatëse:

- “Kontratën e kredisë” nr. 10975 rep., nr. 4604 kol., datë 19.12.2025, nënshkruar midis palëve, e cila do të përdoret për ndërtimin/instalimin e kapaciteteve magazinuese të energjisë elektrike në bateri, me qëllim magazinimin e energjisë elektrike së prodhuar nga parku fotovoltaiik 50 mw;

- “Marrëveshje siguruese mbi kuotat e pjesëmarrjes në shoqëri” me nr. 10978 rep., nr. 4607 kol., datë 19.12.2025, me anë të së cilës shoqëria “Nova Construction Group” sh.p.k. i jep të gjithë

pjesën/kuotën që zotëron te shoqëria “Nova Solar System” sh.p.k. (në cilësinë e ortakut që zotëron 80% të kapitalit), me të cilën siguron pagesën, përmbushjen dhe shlyerjen e detyrimeve nga kredia bankare;

- “Marrëveshje siguruese (marrëveshje e barrës siguruese kuota/aksione)” nr. 894 rep., nr. 312 kol., datë 30.1.2026, me anë të së cilës z. Agim Zeqo i jep të gjithë pjesën/kuotën që zotëron te shoqëria “Nova Solar System” sh.p.k. (në cilësinë e ortakut që zotëron 20% të kapitalit), me të cilën siguron pagesën, përmbushjen dhe shlyerjen e detyrimeve nga kredia bankare;

- Pika 3 – Shoqëria ka shlyer të gjitha detyrimet financiare ndaj ERE-s.

6. Kushtet e vendosura për dhënien e autorizimit

- Dhënia e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Nova Solar System” sh.p.k., si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve, nuk e përjashton këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimet ose miratimet e nevojshme nga organet e tjera kompetente apo nga palët e treta përkatëse, në rast se kjo kërkohej nga kuadri ligjor ose nga marrëveshjet kontraktuale në fuqi.

Vendosja e këtij kushti bëhet për të garantuar se autorizimi i dhënë nga ERE mbetet i kufizuar vetëm në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj rregullatore, pa ndërhyrë apo anashkaluar detyrimet ligjore ose kontraktuale që mund të ketë shoqëria ndaj autoriteteve të tjera ose palëve të përfshira në marrëdhënie financiare apo tregtare. Në këtë rast, duke qenë se marrëveshja është nënshkruar me bankë vendase, është përgjegjësi e shoqërisë të respektojë çdo detyrim tjetër jashtë kompetencës së ERE-s që mund të rrjedhë nga këto marrëveshje.

- Në referencë të nenit 9, pika 8 të rregullores, ku citohet se shoqëria duhet të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar, ku të reflektohet ndryshimi, vendosja e kolateralit mbi kuotat e saj, shoqëria duhet të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar të QKB-së nga ku të reflektohet ky ndryshim/transferim.

- Shoqëria detyrohet të njoftojë ERE-n në rast të heqjes së barrës siguruese ose të ekzekutimit të saj të detyrueshëm.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Nova Solar System” sh.p.k. si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimeve ndaj bankës “Raiffeisen Bank” sh.a. (për kontratën e kredisë nr. 10975 rep., nr. 4604 kol., datë 19.12.2025 dhe marrëveshjet siguruese nr. 10978 rep., nr. 4607 kol., datë 19.12.2025; nr. 894 rep., nr. 312 kol., datë 30.1.2026).

2. Dhënia e autorizimit nga ERE, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi, nuk e çliron shoqërinë “Nova Solar System” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

3. Shoqëria “Nova Solar System” sh.p.k. të njoftojë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi kuotat ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, në zbatim të pikave 2 dhe 3, si dhe në rast të depozitimit të dokumentacionit të ndryshëm nga ai që i ka shërbyer kësaj vendimmarrjeje.

5. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Nova Solar System” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 44, datë 11.2.2026

**MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA
ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT
QË KONTROLLON INTERESAT E
SHOQËRISË “PARISOL” SHPK**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 5, 7, 9, pika 4 dhe 5, dhe nenit 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit, si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.2.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 175/4 prot., datë 10.2.2026, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Parisol’ sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj”, konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënien e autorizimit për shoqërinë “Parisol” sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Kërkesa për marrjen e autorizimit

- Shoqëria, me shkresën nr. 175 prot., datë 15.1.2026, ka paraqitur kërkesën, në lidhje me marrjen e pëlqimit për transferimin e kuotës së ortakut të shoqërisë “Parisol” sh.p.k., z. M. D., i cili zotëron 70% të kapitalit të saj, tek z. A. Sh.

2. Shqyrtimi i kërkesës dhe kërkesa për dokumentacion plotësues

- Shoqëria “Parisol” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 220, datë 23.10.2024, për centralin fotovoltaiik me kapacitet 2 mw në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.



- ERE, me shkresën nr. 175/1 prot., datë 23.1.2026 dhe *email*-in e nisur në datën 26.1.2026, protokolluar në vijim me nr. 175/2 prot., datë 26.1.2026, i ka bërë me dije informacionin /dokumentacionin që nevojitet të plotësohet në këtë aplikim.

- Shoqëria, me shkresën nr. 175/3 prot., datë 2.2.2026, ka përcjellë informacionin e kërkuar.

3. Përfundime dhe kërkesa të tjera për dhënien e autorizimit

- Nga analiza që iu bë dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria “Parisol” sh.p.k., rezulton se është dorëzuar dokumentacioni në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenet 5 dhe 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/ aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/ aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit, si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2022, si vijon:

- Neni 5, pika 2 – kërkesa dhe dokumentet shoqëruese janë nënshkruar nga administratori i shoqërisë dhe/ose përfaqësuesit ligjor të autorizuar me prokurë.

Plotësimi i kërkesave të nenit 5:

- Neni 5, pika 4 – Dokumentacioni është paraqitur në gjuhën shqipe, në format origjinal ose të noterizuar dhe i shoqëruar me kopje elektronike;

- Neni 5, pika 5 – Shoqëria ka bërë me dije se informacioni dhe dokumentacioni i dorëzuar në këtë aplikim duhet të mos jetë i hapur për publikun, pasi përmbajnë informacione tregtare konfidenciale të shoqërisë dhe ortakëve të saj.

- Pavarësisht kërkesës së shoqërisë për konfidencialitetin tërësor të dosjes, ERE, në zbatim të “Rregullores për mbrojtjen e informacionit konfidencial”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 65, datë 26.3.2018, ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, si dhe të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, ka kryer shqyrtimin e dokumentacionit për të identifikuar konkretisht dokumentet apo pjesët e dokumentacionit që trajtohen si konfidenciale, në përputhje me legjislacionin dhe aktet nënligjore të sipërcituara. Nga analizimi i dokumentacionit të depozituar, pjesët e vlerësuara si konfidenciale apo

ato për të cilat kërkohet kryerja e fshirjeve përkatëse, do të trajtohen si konfidenciale, si më poshtë: Shkresa e shoqërisë “Parisol” sh.p.k., e datës 15.1.2026, me lëndë “Kërkesë për dhënien e autorizimit nga ERE, për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e të licencuarit” (ky dokument do të konsiderohet si konfidencial, duke qenë se përmban të dhëna personale të administratorit të shoqërisë, si dhe informacione të aktivitetit tregtar të vetë shoqërisë);

- Fotokopja e noterizuar e *email*-it të “Intesa SanPaolo Bank” sh.a., e datës 9.1.2026, drejtuar administratorit të shoqërisë (ky dokument do të konsiderohet konfidencial, duke qenë se përmban informacione personale identifikuese të personave fizik të cilët përfaqësojnë “Intesa SanPaolo Bank” sh.a., të tilla si: emër, mbiemër, nr. cel., adresën e *email*-it).

Për sa më sipër, do të konsiderohen dhe trajtohen si jokonfidencial, për arsye se janë dokumente të aksesueshme pranë institucioneve publike kompetente, dokumentacioni si vijon:

- Ekstrakti i regjistrit tregtar i shoqërisë “Albanian General Electricity” sh.p.k.;

- Ekstrakti i regjistrit tregtar i shoqërisë “Aksent L&BC” sh.p.k.;

- Ekstrakti i regjistrit tregtar i shoqërisë “Parisol” sh.p.k.;

(Ekstraktet e regjistrit tregtar të shoqërive të sipërcituara, do të konsiderohen si jokonfidenciale, në rrethanat që janë të publikuara dhe të aksesueshme pranë institucioneve publike kompetente, në rastin konkret QKB);

- Marrëveshja paraprake për shitblerje kuote, e datës 9.1.2026 (ky dokument do të konsiderohet jokonfidencial, por me redaktim selektiv të elementeve që kanë të dhëna financiare sensitive dhe të dhëna personale.

4. Plotësimi i kërkesës sipas nenit 7:

- Pika 1 – Janë paraqitur të gjitha të dhënat e kërkuara mbi shoqërinë, përfaqësuesin e autorizuar, arsyet mbi ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit, efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit dhe ndikimin e transferimit në ushtrimin e aktivitetit të licencuar, një përshkrim të kandidatit të propozuar, informacion mbi kontributin financiar që do të japë;

- Pika 2 – Janë dorëzuar të gjitha dokumentet përkatëse, përfshirë ekstraktin historik të regjistrit tregtar, vendimet e organeve drejtuese,



marrëveshjen përkatëse dhe dokumentacionin tjetër shtetëror, si më poshtë vijon:

- germa “a” – ekstrakti historik i regjistrit tregtar;
- germa “c” – vendimi i organeve drejtuese: është depozituar vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë “Parisol” sh.p.k., datë 17.12.2025, nëpërmjet të cilit është miratuar shitja e kuotës;

- germa “d” – marrëveshjet paraprake përkatëse: “Marrëveshje paraprake për shitblerje kuote”, datë 9.1.2026, nënshkruar midis palëve, me anë të së cilës është dakordësuar transferimi i kuotës nga ortakut aktual z. M. D. (i cili zotëron 70% të kuotës së kapitalit të shoqërisë) tek z. A. Sh.;

- Pika 3 – Shoqëria ka shlyer të gjitha detyrimet financiare ndaj ERE-s.

5. Kushtet e vendosura për dhënien e autorizimit

- Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Parisol” sh.p.k., nuk e përjashton këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimet/miratimet e nevojshme nga palë të treta, në rast se kërkohet prej tyre.

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 9, pika 8, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit”, miratuar me vendimin nr. 235, datë 26.11.2021, shoqëria duhet të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar të QKB-së nga ku të reflektohet ky ndryshim/transferim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut kryesor që kontrollon interesat e shoqërisë “Parisol” sh.p.k., sipas strukturës së kërkuar për 70% të kuotave të kapitalit nga z. M. D. tek z. A. Sh.

2. Shoqëria të informojë ERE-n menjëherë pasi të disponojë/marrë miratimin përkatës të Intesa SanPaolo Bank (konfirmimin nga banka mëmë), në lidhje me dakordësinë për ndryshimin e ortakut të shoqërisë, lidhur me detyrimet që i burojnë

shoqërisë nga kontratat e kredive të nënshkruara me bankën, datë 18.4.2025.

3. Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Parisol” sh.p.k., nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto palë.

4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, në zbatim të pikës 2, si dhe në rast të depozitimit të dokumentacionit të ndryshëm nga ai që i ka shërbyer kësaj vendimmarrjeje.

5. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Parisol” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

KËRKESË

Shtetai Shkëlqim Merkohasanaj kërkon pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë shpalljen të zhdukur të shtetasit Azbi Merkohasanaj, i zhdukur prej shkurtit të vitit 1992, i datëlindjes 16.2.1954, lindur në Gjirokastrë.

KËRKUES
Shkëlqim Merkohasanaj

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 160 lekë

